



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 001/060 – 26743

Më: 04 mars 2024

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 04 mars 2024, në Sallën e mbledhjeve të KPF-së, në “Shtëpinë e Bardhë”, me fillim në ora 10:12 minuta.

Pjesëmarrës nga KPF-ja, ishin: Antigona Bytyqi, Kryesuese e KPF-së, Karanfil Haxhillari, Dafina Alishani, Adem Shabanaj, Egzona Hoxhaj, Naxhije Memaj, Florent Ukaj, Levent Buş dhe Bajram Kastrati, të gjithë anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pjesëmarrës tjerë ishin: Kujtim Gashi, Nënkyetar i Komunës, Ramadan Tarashaj Drejtor i DTZHE -së, Çelë Lama, Drejtor i DSHP-së, Gjafer Ponik nga DEF, Pranverim Berisha, Drejtor i DUPH-së, Sadije Jakupi, Kryesuese e Komitetit për Arsim, Islam Thaqi, Kryesues i Komitetit për Shëndetësi, KFOR-i Zvicran., si dhe OJQ-të e Mediat.

Antigona Bytyqi: Përshëndetje të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, i nderuar Nënkyetar, të nderuar drejtor, zyrtar të tjerë, po e përshëndesim edhe prezencën e KFOR-it Zvicran, poashtu përfaqësuesin nga OSBE, përshëndetje për të gjithë. Sot siç jeni njoftuar e kemi thirr mbledhjen e radhës të Komitetit për Politikë dhe Financa. Prezent jemi 8 anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mund të fillojmë me punimet e kësaj mbledhjeje. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë rend dite:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për vënien në shqyrtim publik të planit rregullues të hollësishëm “zona e parkut për industri të lehtë në Prizren - Parku i Biznesit”, sipas hartës zonale të Komunës së Prizrenit, (sipas kërkesës të MMPHI);
4. Shqyrtimi dhe miratimi propozim-rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 001/011-99275 të datës 30 qershor 2022 për taksa komunale;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-strategjisë komunale dhe planit të veprimit për personat me aftësi të kufizuara 2024-2027;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit mbi shpalljen e interesit të përgjithshëm (Zonë të veçantë – Parku i Biznesit);
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr. 001-011- 182 mbi shpalljen e interesit të përgjithshëm publik;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr. 001/011-14771 të dt. 27 janar 2022, sipas Rekomandimit të Komitetit për Komunitete;

9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale “Ndërmarrja Publike Banesore dhe Parkingjet” SH.A. në Prizren;
10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.001/011-157578 të datës 31 tetor 2022 (Këshillin e fshatit Zym të Hasit);
11. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.001/011-64795 të datës 04 maj 2023 (KKA i NPL “Stacionit Autobusëve”);
12. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Trungu i Qarrit (*Quercus cerris*) në fshatin Vlashnjë të Prizrenit, si Monument i Natyrës;
13. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: “Shpellat” në fshatin Shkozë të Prizrenit, si Monument i Natyrës;
14. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Burimi i ujit natyral në Vërmicë, si Monument i Natyrës;
15. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: “Burimi i ujit natyral”, në Poslishtë, si Monument i Natyrës;
16. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Kompleksi i pishave (*Pinus nigra*) në fshatin Malësi e Re të Prizrenit, si Peizazh i Mbrojtur;
17. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Humnerë në Lubizhdë e Hasit të Prizrenit, si Monument i Natyrës;
18. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: “Trungu i Vjosës-Vadhës” (*Sorbus domestica L.*) në fshatin Lubizhdë e Hasit të Prizrenit, si Monument i Natyrës;
19. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Trungu i rrënjës (*Quercus robur*) në fshatin Kabash i Hasit të Prizrenit, si Monument i Natyrës;
20. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Trungu i rrënjës (*Quercus robur*) në fshatin Zym të Prizrenit, si Monument i Natyrës;
21. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: “Liqeni karstik i Zymit” në Prizren, si Monument i Natyrës;
22. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: “Shpella” në fshatin Zym të Prizrenit, si Monument i Natyrës;
23. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: “Trungu i Rrënjës” (*Quercus robur*) në fshatin Romajë të Prizrenit, si Monument i Natyrës;
24. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: “Kompleksi i Trunqeve” (*Quercus sp.*) në fshatin Dedaj të Prizrenit, si Monument i Natyrës;
25. Vazhdim i diskutimit të raportit për 6 (gjashtë) mujorin e dytë të Kryetarit të Komunës;
26. Raporti financiar për periudhën tetor-dhjetor 2023;
27. Raporti për zbatimin e planit të integritetit në Komunën e Prizrenit, për vitin 2023;
28. Raporti i performancës të Komunës së Prizrenit, për vitin 2022;
29. Informatë rreth raportit të punës të Zyrës së Përfaqësuesit Ligjor të Komunës për vitin 2023.
30. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023;
31. Raportet e punës të Komiteteve të themeluara nga Kuvendi i Komunës, për vitin 2023:
 - Komitetit për Politike dhe Financa,
 - Komitetit për Komunitete,
 - Komitetit për Arsim,
 - Komitetit për Shëndetësi

Antigona Bytyqi: Këto pra janë pikat e rendit të ditës, po fillojmë menjëherë me pikën e parë.

Pika e parë:
shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës.

Antigona Bytyqi: A ka dikush diçka me shtuar për rend dite? Urdhëro drejtor.

Çelë Lamaj: Drejtorja e Shërbimeve Publike, kërkon që me u fut edhe një pikë e rendit të ditës për vendosjen e reklamave në territorin e komunës së Prizrenit, domethënë janë përcaktuar lokacionet ku mund të vendosen billbordat, Citylight edhe reklama të tjera në territorin e komunës së Prizrenit. Prandaj kërkohet që në seancën e ardhshme na ta bëjmë këtë. propozim që këto hapësira publike t'i shfrytëzojmë për një procedurë të ardhshme të tenderimit për vendosjen e reklamave dhe elementeve të tjera reklamuese në qytetin e Prizrenit.

Antigona Bytyqi: Faleminderit drejtor. Dikush tjetër?

Karanfil Haxhillari: 31 pika janë, unë mendoj që duhet me i heq disa sosh edhe prej tyre konsideroj që këto raportet besoj që më falin Sadija, Islami.

Antigona Bytyqi: Konkretisht për pikën 31 e ke fjalën?

Karanfil Haxhillari: E kam fjalën, informatë rreth raportit të punës të zyrës së përfaqësuesit ligjor edhe pse s'koka këtu, për me u largu, shqyrtimi i raportit të punës kuvendit meqë s'ka votime domethënë 30, 31 dhe 32 raporti i punës të komiteteve të themeluara nga kuvendi. Unë e di që janë shumë të nevojshme po në ndonjë seancë a din kur e kemi më pak ngarkesë përgjatë vitit mundemi me i me fut, por ama duhet me i shkarku. 31 pika të rend të ditës 32 pikë ditës tash 33.

Çelë Lamaj: Më falni 13 pikë i ditës ato janë që nuk marrin shumë.

Karanfil Haxhillari: Edhe raportin e planit të integritetit të komunës, edhe 27-shin edhe ky është raport.

Haziz Krasniqi: Jo, e kemi obligativ, është obligativ,

Antigona Bytyqi: Ndoshta mundemi 28-shin po për me shty një tjetër mbledhje.

Haziz Krasniqi: 28-shin po bënë për mbledhje tjetër.

Karanfil Haxhillari: Raporti i performancës apo?

Haziz Krasniqi: Po.

Karanfil Haxhillari: çfarë afati ka ky raporti?

Haziz Krasniqi: Sepse sistemi i performancës aktualisht është i hapur edhe jemi duke raportu. Domethënë, ky raport duhet me kaluar në kuvend edhe pastaj me e përdor në sistem të performancës.

Ndërsa raporti i performances për vitin 2022, mundemi me shty në mbledhjen e radhës sepse tash është ngri si indikator edhe muj veç me dhënë si informacion.

Karanfil Haxhillari: Nëse mundem propozime të tjera por unë e kisha thënë se me kujdes e kam lexu edhe pikën për ndërmarrjen publike banesore edhe parkingjet. Kam has shumë gjëra që duhet me i diskutu, edhe shumë gabime, më përpara vetë titulli, domethënë në një ndërmarrje bashkë nuk ndërmarrja publike banesore dhe parkingjeve, unë konsideroj që janë dy gjëra të që s'kanë të bëjnë kurrgjë me njëra tjetrën. Po ashtu sipas informatave e kishit caktuar një ekip ekspertësh që është thënë, por që ish ajo ekip avokatie, nuk ishte ekip ekspertësh që kanë njohuri për ndërmarrjet publike, dhe kriteret. Në qoftë se hymë më thellë në këtë material, unë shoh shumë mangësi, dhe në fakt nuk e kam të qartë çka po doni me bë, a po doni me bë ndërmarrje publike apo firma ndërtuese? Vetëm një shembull po e marr drejtor, për shembull, tek kjo, edhe pse unë e kisha dashtë me kanë kompania, përfaqësuesit e qasaj kompanisë Res-publika, hyna me kqyr në Google doli në New York ajo! Veç ta gjej një sekondë, që më la shumë përshtypje!

Dafina Alishani: kush është sponsorizues i kësaj pike?

Çelë Lamaj: Drejtorja e shërbimeve publike.

Karanfil Haxhillari: Thotë veprimtaria e ndërmarrjes publike banesore dhe për parkingjet në Prizren është: Ndërtimi i objekteve banesore afariste, industriale, shkolla, spitale e të tjera! A mundeni me më kallëzu ndërmarrja publike banesore me ndërtu shkolla, spitale, a din diqysh jashtë!

Çelë Lamaj: A ka nevojë për s'qarim?

Karanfil Haxhillari: Duke i përfshirë edhe punët zejtare përfundimtare,! Unë kisha thanë me i hjek qeta se gabim a e din.

Çelë Lamaj: Dëgjo, nëse është gabim na e kthejnë ministria e pushtetit lokal ligjshmërinë e saj dhe dokumentin të cilin ne, Drejtorja e Shërbimeve Publike, në këtë rast komuna e Prizrenit e ka një konsulencë, të cilës ja kena dhënë si detyrë për me na përgatitur për një ndërmarrje publike banesore me parkingje për menaxhimin e tyre. Nëse thua a ka lidhje diçka banimi me parkingje? ka shumë lidhje a din se kemi shumë banesa të cilat në kuadër të vetin kanë parkingje edhe është problem i menaxhimit të qytetarëve. Ato parkingje a mund t'i shfrytëzojnë vetëm banesat, a munden me i shfrytëzu edhe qytetarë të tjerë, nuk ka të shkruar diçka edhe nëse i shkruan banorët e lagjes futet dikush tjetër aty që ti s'mundesh me i kontrolluar krejt këto. Atëherë edhe ata kanë me i marrë me i menaxhu edhe këto. Domethënë ne kemi mendu që mos të formojmë shumë ndërmarrje publike, por me një ndërmarrje të përshihen të dyja të cilat kanë ngjashmërinë njëra me tjetrën. Sa i përket veprimtarisë ndërmarrjes publike banesore është e përcaktuar me ligj edhe këto që po i thua ti, janë krejt të përcaktuara me ligj, shënohen në ligj edhe në seancën e ardhshme mund me ja u konsulencën aty edhe me ju bë s'qarime ligjore normalisht që ta dini, që ta kemi qartë se a mund të bëhet ndërtim që edhe unë kur e kam parë në fillim e kam thirr unë se ne nuk e kena marrë atë dokument edhe po bindu dhe pa e lexu e kam lexuar disa herë atë edhe i kemi

konsultuar dhe na ka thënë që brenda ligjit ekzistojnë domethënë këto klauzola të cilat futen në ndërmarrjen publike banesore. Tash qysh ka me qenë forma e saj normalisht se ka mu përgatit një statut edhe një rregullore ndërmarrjes edhe ajo ka me i përcaktuar dhe ka me i detajizuar krejt ato se cilat janë veprimtaritë ligjore që mundet me i pas ajo ndërmarrje. Kështu që nëse jeni të interesuar kam me pas s'qarime shtesë normalisht ditën e seancës, domethënë ditën e mërkurë unë e thërras konsulencën të jetë aty prezent edhe të na i sqaron komplet edhe juve, mua ma kanë sqaruar, po t'jua sqaron edhe juve fushveprimtarinë e një ndërmarrje të tillë publike.

Antigona Bytyqi: Faleminderit drejtor, dikush tjetër rreth rendit të ditës? Atëherë, në qoftë se nuk keni, po shkojmë me propozimet si u bë me radhë. Është propozuar nga drejtori që të shtohet edhe një pikë për vendosjen e reklamave në territorin e komunës së Prizrenit.

Dafina Alishani: Më fal a është aq me urgjencë me e fut këtë rend këtë, sepse është e ngarkuar?

Çelë Lamaj: Po dëgjo, a din pse po të them është me urgjencë, se kanë me na marrë goxha kohë procedurat e tenderimit, ne nuk e dimë se nesër kanë me na u dashtë, tash edhe partive politike për reklamimin e fushatës që mund të na ndodhin gjatë këtij viti. Kështu që kjo kohë mundet me na marrë deri nga muaji shtator si procedura, po ka dhe shumë kërkesa të tjera të hapësirave publike të cilët kërkojnë qytetarët reklamimin e shumë produkteve të tyre që ka nevojë qyteti i Prizrenit, ka disa vjet i cili nuk i menaxhon këto dhe shumë është me rëndësi që të kalohen si lokacione të përshtatshme, ka dalë një komision i ka verifikuar edhe t'i hapin procedura të tjera në të ardhmen.

Florent Ukaj: A kemi material se ku janë lokacionet?

Çelë Lamaj: Po i kemi, po e kemi materialin komplet ku janë lokacionet, këtu i kemi me lista poseduese po keni me pas edhe formën e reklamave, normalisht se për këto krejt këto reklama, pastaj kena me kërku leje ndërtimi për lokacionet e sakta, me dimensione ne e kemi një farë prezentimi. të asaj që e kemi bërë si drejtori.

Karanfil Haxhillari: Për punën e subjekteve politike, KQZ-ja i sqaron këto se ku munden me bë.

Çelë Lamaj: Po dua me thënë që edhe ato i kanë shfrytëzuar gjithmonë a din, sidomos shtyllat i kanë shfrytëzuar, po nuk është kjo vetëm se ajo është një fushatë, kjo ka me qenë një kontratë 3 vjeçae.

Dafina Alishani: Kjo çështje që pret edhe një muaj nuk ma merr mendja që është problem për shkak që është e ngarkuar.

Çelë Lamaj: 13 pika nuk kemi pas diskutime, janë veç votim.

Dafina Alishani: Po veç kur na po bëjmë pyetje po thoni është shumë e ngarkuar, tash po bini pika shtesë.

Çelë Lamaj: Ne s'kena thënë asnjëherë, ne s'kemi thënë që është e ngarkuar asnjëherë.

Dafina Alishani: Ja është dikush tjetër në seancë ja s'po di unë. Saher ngrisim çështje thoni është e ngarkuar.

Antigona Bytyqi: Po shkojmë propozimet po i hedhim në votim. Kështu që qysh t'ja u merr mendja. Atëherë po shkojmë me propozimin e drejtorit.

Bajram Kastrati: Më fal Kryesuese. A është veç inicim për vendim apo, a ke me marrë vendim, forma se nuk kesh këtu?

Kujtim Gashi: Vendim për me leju,

Çelë Lamaj: Për me leju lokacionet për me mujt me vendos reklamën,

Bajram Kastrati: Do të thotë po dasha me shqyrtu si pikë.

Çelë Lamaj: Po.

Antigona Bytyqi: kemi pika shumë, unë po e hedh në votim. Prezent jemi tetë, kush është për që kjo pikë të hyjë në rend dite? Katër jemi për, tre kundër dhe një abstenim. Atëherë hyn kjo pikë e rendit të ditës. Shkojmë me propozimet e tjera, po fillojmë me radhë sipas rendit. Pika e nëntë është propozuar, shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin e ndërmarrjes publike lokale, ndërmarrje publike banesore dhe parkingjet ShA.në Prizren, që të largohet nga rendi i ditës. Kush është për që të largohet, tre jemi për dhe pesë kundër. Atëherë kjo pikë nuk largohet nga rendi i ditës. Po shkojmë te pika e 28. Kush është për që të largohet kjo pikë e rendit të ditës? Po tetë jemi për, atëherë largohet pika e 28. Pika e 29, unanimisht. Pika e 30. Unë kështu vetëm pak para se me hedh në votim, nëse pajtoheni normalisht Karanfili propozoi që në një seancë tjetër. Nuk e mendoj si raporte që është dashur me dhjetor, në janar, prapë e vendosim bashkarisht, po kisha thënë me shku të drejtë e në publikim, meqë me u konsumu, kanë ardh që tre herë.

Dafina Alishani: Në seancën e radhës e diskutojmë.
Karanfil Haxhillari: ato janë raporte që i kemi edhe të përfshihime.

Dafina Alishani: Ato janë raporte të cilat duhet me u raportu edhe duhet me kërku tani përgjegje prej drejtorëve.

Antigona Bytyqi: Nuk janë të drejtorëve këto.

Dafina Alishani: Na duhemi me ditë komisionet a kanë bashkëpunim me drejtori edhe a po i majnë. Këta janë tu harxhu kohë dhe janë vullnetarisht tu e kry punën, e mos mi ngu në kuvend nuk është e drejtë.

Antigona Bytyqi: Jemi te pika 30, raporti i punës së kuvendit a me e sjellë edhe njëherë apo mundem e pubiku?

Karanfil Haxhillari: Në raportin e punës së kuvendit, jemi të përfshirë krejt kuvendarët.

Antigona Bytyqi: Në rregull, atëherë këto vendosem me hjek. Kush është për me u largu? Unanimisht. Tash te pika e 31, e kemi Komitetin për Politikë dhe Financa, Komitetin për Komunitete, Komitetin për Arsim edhe Komitetin për Shëndetësi, deri tash janë që i kanë sjellë materialet. Atëherë për këto jeni të pajtimit me sa po e shoh.

Karanfil Haxhillari: Këto dy të fundit Komiteti për Arsim edhe për shëndetësi le të vijnë po këto.

Adem Shabanaj: Tash na, seancat e kuvendit bëhen për këto punë po unë po e vërej se çdo mbledhje po diskutohet është e stërzgjatur është e zgjatur, le të zgjatë dy ditë, për këtë punë jemi të thirrur si kuvendar dhe me i diskutuar këto gjëra. Unë Sadijen e pashë që dy mbledhje vjen këtu, e treta me radhë sot edhe mos po hyn në hak edhe Sadijës pak.

Antigona Bytyqi: Atëherë pikën 31.

Florent Ukaj: Kush ka material le të vjen të raporton.

Karanfil Haxhillari: S'ka me të mbetë kerkush.

Sadije Jakupi: Problemi është që na jemi tuj punu. E tha Dafina çështjen tjetër për diçka tjetër. Mirëpo viti shkollor po shkon, pushimin pranveror e keni në prill, mandej në qershor. Nëse jo tash, e doni prillin se duhet me qenë edhe statistikat, diçka që jemi tu punu, nuk është që po shkon krejt për mua.

Antigona Bytyqi: Ani po e qesim pikën e 31 komplet.

Sadije Jakupi: Vijnë tjetër herë, hiç nuk ka problem, na jepet edhe afat tjetër. Veç qeshtu ma mos luani hajgare se nuk vij ma.

Antigona Bytyqi: Kush është pika e 31 për me u largu?

Dafina Alishani: Jemi për me u diskutu në kuvend, po s'ka nevojë tash me qëndrua Sadija, se ka ardhur është hera e tretë edhe raportimin e ka ba së fundi në KPF.

Antigona Bytyqi: A po e lëmë edhe KPF-në?

Dafina Alishani: Po tash mos t'i diskriminojmë.

Bajram Kastrati: Kur me ardhë në këtë seancë apo?

Antigona Bytyqi: Po për këtë seancë.

Bajram Kastrati: Edhe nëse stërgjatet e shtyjme për ditën tjetër, tek e fundit, më mirë t'i kryejmë.

Antigona Bytyqi: Atëherë, kundër ishit të gjithë për me u largu. Kush është për që të vjen në seancë? Unanimisht, faleminderit. Atëherë po hedhi në votim pikën e rendit të ditës me propozimet. Propozimi i parë që e dha drejtori domethënë hyn në rend dite, po ashtu edhe pika e nëntë. Largohe

pika e 28, 29, 30 edhe pika e 31 mbetet. Tani po hedhi në votim rendin e ditës. Prezent jemi tetë anëtarë, Unanimisht miratohet rendi i ditës, faleminderit. Kalojmë te pika e dytë.

Pika e Dytë:

Shqyrtimi dhe miratimi i draftplanit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2024.

Antigona Bytyqi: Kjo pikë është diskutuar dhe njëherë te Komiteti për Politikë dhe Financa, domethënë janë kry krejt procedurat, në qoftë se nuk kemi diçka me diskutu, po e hedhi menjëherë në votim.

Karanfil Haxhillari: Unë kisha thënë që këto pikat e fillimit i kemi diskutuar në KPF veç, edhe kisha thënë vetëm me rekomandu.

Antigona Bytyqi: Atëherë kush është që pika e dytë t'i rekomandohet mbledhjes së ardhshme? Unanimisht, faleminderit, prezent kemi shtatë. Kalojmë te pika e tretë.

Pika e tretë:

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për vënien në shqyrtim publik të planit rregullues të hulumtueshëm zona e parkut për industri të lehtë Parku i Biznesit sipas hartës zonale të komunës së Prizrenit dhe sipas kërkesës së ministrisë,

Antigona Bytyqi: kush është për që të miratohet edhe pika e tretë, ti rekomandohet mbledhjes së ardhshme? Shtatë prezent, unanimisht, faleminderit. Kalojmë te pika e katërt.

Pika e katërt:

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores të datës 30 qershor 2022 për taksa komunale.

Antigona Bytyqi: Prezent jemi shtatë anëtarë, kush është për që edhe pika e katërt të rekomandohet? unanimisht, faleminderit. kalojmë te pika tjetër.

Pika e pestë:

Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-strategjisë komunale dhe planit të veprimit për personat me aftësi të kufizuara 2024-2027.

Antigona Bytyqi: Kush është për? unanimisht, faleminderit. kalojmë te pika tjetër.

Pika e gjashtë:

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm zonë të veçantë Parku i Biznesit.

Antigona Bytyqi: Kush është për? Unanimisht edhe kjo i rekomandohet i mbledhjes. Kalojmë te pika tjetër.

Pika e shtatë:

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit mbi shpalljen e interesit të përgjithshëm publik

Antigona Bytyqi: Kush është për? unanimitisht, faleminderit.

Pika e tetë:

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të datës 27 janar 2022 sipas rekomandimit të Komitetit për Komunitete.

Antigona Bytyqi: Kemi diskutuar, anëtari që ka mu ndryshu. Kush është për? unanimitisht faleminderit. Kalojmë tek pika tjetër.

Pika e nëntë:

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për themelimin e ndërmarjes publike lokale - ndërmarja publike banesore dhe parkingjet SHA. në Prizren.

Antigona Bytyqi: A keni diçka me Diskutu? Drejtor a keni diçka me e sqaruar?

Çel Lamaj: ne veç se e sqaruam. Atëherë në bazë të nenit 12 paragrafit 2 pika d), nenit 17 pika 1 dhe neni 40 paragrafi 2 pika a) të ligjit numër 03 /L-040 për Veteqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës numër 28 / 2008) në mbështetje të nenit 6 të Ligjit numër 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit numër 03/L-087 për ndërmarjet publike (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës numër 13 / 2012) i plotësuar dhe i ndryshuar me ligjin numër 05/L-009 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës numër 10 / 2015) e konfirmon nenin 4 lidhur me nenin 5 të rregullores numër 02/2013 mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale dhe pjesëmarrjen e komunave në bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve rajonale. Kuvendi i komunës së Prizrenit në mbledhjen e mbajtur me datën miraton këtë projekt vendim. Unë ja u dhashë për çka është themelimi i kësaj ndërmarrje. Ndërmarrja banesore e cila ka për komunën e Prizrenit, kemi shumë objekte të banimit prej para luftës, të cilat momentalisht nuk menaxhohen, e dimë se gradualisht këto objekte kanë probleme në mirëmbajtje, domethënë njëfarë forme nuk i ka kërkush me mbikëqyrë. Duke e parë që ka me pasur nevojë për intervenime, atëherë ne kemi menduar që të formohet kjo ndërmarrje e cila do t'i trajtojë të gjitha objektet të përcaktuara në bazë të një rregullore të cilën do të bëhet një ndërmarrje që do të formohet edhe një rregullore e cila do të bëhet se si do të menaxhohen komplet banimet e larta. Është fjala për banimet e larta dhe sipërfaqet e atyre objekteve të cilat kanë qenë të planifikuara me plane urbanistike ku janë marrë edhe lejet të ndërtimit në atë kohë. Ne e dimë që kemi problem në kulmet e objekteve shumë, kemi problem me fasada, kemi problem në mirëmbajtjen e pjesëve publike, korridoreve edhe në këtë rast edhe shumë kërkesave për ashensor, të cilët disa objekte i kanë, disa nuk i kanë, edhe kjo ndërmarrje do t'i menaxhojë të gjitha këto, në kuadër të kësaj. Kemi planifikuar që edhe parkingjet që e thashë edhe më herët, që janë të nevojshme që t'i trajtojmë. Komuna e Prizrenit, që ka disa vite të cilët nuk menaxhohen prej komunës edhe kemi menduar që me një ndërmarrje publike do të jetë shumë më efikase, se jo të shkohet në formën e tenderimit të dhënë një operatori për një kohë të caktuar. Kështu që si ndërmarrje publike mendojmë që kanë me u trajtuar dhe kanë me u menaxhu shumë më të drejtë dhe më mirë domethënë pronat publike. Kjo është kërkesa e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për formimin e kësaj ndërmarrje që nesër të jetë shumë më funksionale në menaxhimin

edhe të objekteve të banimit, banimit të lartë kryesisht banimin publik edhe të parkingjeve në përgjithësi, jo vetëm të parkingjeve publike, por dhe të parkingjeve të cilat janë të paraparamë me plane urbanistike brenda komplekseve të banimit, faleminderit.

Antigona Bytyqi: Faleminderit drejtor. Po Dafina urdhro.

Dafina Alishani: Unë veç jam e interesime a ka ndërru PDK-ja kahje, u bë social-demokrate a ka është puna? Se ju për ndërmarje publike hiç s'keni qenë politikisht, nuk keni qenë të afërt! Tash çka ndodhi me PDK-në që goxha po i jep zor ndërmarjave publike edhe për parkingje. Ish dashtur ne së paku me ditë ju si DSHP ose edhe ne si qytetarë me dit cilat parkingje kanë me menaxhu? A kemi parkingje të reja të cilat i keni premtuar që kanë me u ba për qytetarët. Tash keni pasur premtime megalomane për parkingje, tash po ktheheni në pikën zero po doni me i bë menaxhimin e këtyre parkingjeve që janë! Shumë mirë që është inicu, po ka dhe çështje të tjera që po thoni mirëmbajtja e objekteve ose kulmeve. Dy vite radhazi ka dështuar kodi buxhetor i kulmeve në Drejtorinë e Urbanizmit edhe nuk janë bërë asnjë mermetim i kulmave! A është patjetër me pas ndërmarje publike? Ju keni pasur kode buxhetore të cilat nuk janë shfrytëzuar! I ke banesat në Ortakoll, i ke çështjet të pritura me vite të cilat nuk janë adresu a ka pas buxhet. A është patjetër me bë ndërmarje publike? Edhe thjesht po më intereson a keni ndërruar orientim politik si PDK? Po e merrni shembull nivelin qendror.

Çelë Lamaj: Unë po ju them diçka që ndërmarjet publike nuk janë si kanë qenë, nuk kanë qenë axhenda të partisë demokratike, po unë jam këtu t'ju sqaroj profesionalisht që ne kemi mendu që me ndërmarje publike menaxhohen shumë më lehtë, Drejtoria e Urbanizmit ka pas një kod buxhetor për mermetimin e disa kulmeve, kur them disa kulme, ajo nuk ka qenë as dy a 3% i nevojave të qytetit se sa ka nevojë qyteti për menaxhimin jo vetëm të kulmeve, edhe të fasadave. edhe gjithë hapësirës tjetër publike përrreth e cila gradualisht na dëmtohet edhe kërkush nuk e ka një farë forme mbikëqyrje. Drejtoria e Shërbimeve Publike, mundohet me projektet e veta t'i menaxhojë edhe parqet, t'i rrethojë, t'i rregullojë. Kurse në këtë rast ka me i marrë një ndërmarje publike e cila mundet me qenë edhe shumë profitabile, domethënë ka me i sjellë edhe të hyra, ka me i sjellë edhe të hyra qytetit kam me i sjellët komunës. Tash nëse mendoni që me një 200 mijë euro ti ke me bë diçka punë të madhe nëse ka pas, nuk e di tash sakt sa ka pas Drejtoria e Urbanizmit.

Dafina Alishani: As 2%-shin, s'keni arritë me hargju.

Çelë Lamaj: Dëgjo unë flas, këtu flas se ne mendojmë se me këtë mermarjen publike kanë me u menaxhu shumë më mirë edhe parkingjet edhe ndërtesat. Kemi pas kërkesa për lifta që janë kosto goxha e madhe, kemi pas nevoja për në meremetimin e korridoreve, kena pas kërkesa për podrumet e tyre të cilat nuk i menaxhon kurkush e shpesh është dashur me intervenu për shkak se ka pas ujnata nëntokësore. Krejt këto ka me i marrë një ndërmarje dhe me siguri ka me i menaxhu shumë më mirë këto se ka me qenë interesi edhe i banorëve por interesi edhe i vetë ndërmarjes e cila ka me qenë se thashë shumë profitabil që ka me mund me i sjellë të hyra edhe komunës. Kjo ka me u rregulluar, besoni që me ndërmarjen publike momentale që e kemi ne për shembull dhe Eko-Regjioni, ju po e shihni që kur kemi qasje ne si komunë dhe kemi ndërmarjen tonë, pastërtia e qytetit është shumë më nivel sesa me ja lënë. Se ne kur kemi ardhur këtu e kemi gjetur edhe një kontratë për një pjesë të qytetit që e ka menaxhu një kompani private edhe ka qenë dallimi

jashtëzakonisht i madh edhe fatmirësisht qajo u shku edhe tashi komplet këtë pjesë e ka marrë Eko- regjioni si ndërmarrje publike ku aksionar kryesor është komuna e Prizrenit e dini me diku 63%. Edhe kjo ndërmarrje publike ka me i menaxhu parkingjet shumë më mirë, ka me i menaxhu banesat edhe hapësirat përreth atyre ndërtesave të cilat janë pronë e përbashkët e atyre banorëve. Kështu që ka me qenë ndoshta një prej ndërmarrjeve më të mira që duhet me i pas jo vetëm Prizreni por çdo qytet tjetër.

Dafina Alishani: Qekjo klauzola e që tha ndërtimi i spitaleve, qysh po mendoni me ndërtu spitale si komunë.

Çelë Lamaj: Dëgjo, unë ju thashë, kjo është një dokument i përgatitur prej një konsulence e cila paguhet prej komunës Prizrenit për formimin e ndërmarrjeve të cilët janë ekspertë të fushës edhe ata kanë me ardhur në seancë edhe bëjani këtë pyetje dhe ka me ju sqaru. Nuk mund t'ju them unë për pjesën juridike të saj, unë mund t'ju them për konceptin të cilin ne e kemi për me mund me e formu një ndërmarrje të tillë. Kurse për pjesët profesionale që me pyet absolut e keni të drejtën e juaj dhe keni me marrë sqarime në seancë.

Dafina Alishani: Unë e kam një rekomandim lidhur me këtë pikë. Për shembull te taksat komunale shumë mirë kena funksionuar, kena pas dëgjim publik mes asambleistëve, i kena dhënë inputet tona, i kemi dhënë mendimet tona, propozimet tona, kushdo që ka pasur sqarime ka ardhur, na ka prezantuar dhe në rregull. Po më duket pak e jo legjitime, po vjen pika për me formu ndërmarrjen e tash po na thoni vjen konsulentja dhe ju informon! Ish dashtur me qenë e kundërta, është dashur me qenë me u informuar asambleistat qysh ka me qenë se në fundja jena tu formu ndërmarrje publike, është peshë e madhe. Tash mu s'po më duhet konsulentja me ardhë në pikën e rendit të ditës ku formohet ndërmarrja, pak ka rëndësi.

Çelë Lamaj: Ta sqaron, edhe ti je a voton apo nuk voton, ajo ta sqaron ty, nëse ti.

Dafina Alishani: Unë e kisha propozuar me bë të njëjtën që kemi pas me taksa komunale, me pas një dëgjim publik me asambleista edhe me e diskutu gjër e gjatë se qysh është planifikuar edhe pse bash. Unë e di pse i jepni zor për ndërmarrjen publike, se vende pune janë për familjarët e juaj.

Çelë Lamaj: Në bazë të juve ne duhet kurgjo mos me i pru, keni qejf ju unë kurgjo mos me punu.

Dafina Alishani: Mos u nxej kadale qetësohu, mos u nxe. Unë kam të drejtë këtu me diskutu dhe me të pyet. Nuk po më duket e logjikshme me ardh konsulentja ditën kur votohet formimi i ndërmarrjes me na informuar neve! Spital nuk mundet me të ndërtu komuna. Nuk po dua unë me votu diçka që nuk është në suazat komunale dhe që nuk ka.

Çelë Lamaj: Ajo ndërmarrje publike ka me pas të drejtë me konkurren, a do me të kallxu tashti, tash ajo ndërmarrje publike ka me pas të drejtë me konkuru në çdo projekt i cili ka me qenë publik për krejt operatorët me ndërtue edhe një spital nëse ka me formu kapacitete të tilla që ka me mund me bë. Domethënë si veprimtari që mundet me ushtru si ndërmarrje publike ka me pas të drejtë edhe qatë me bë, gradualisht edhe spital edhe shkollë edhe ndërtim. Domethënë ka me, për qatë të thash që kjo ka me qenë ndërmarrje shumë profitabile në një konkurrencë të tregut të lirë, kërkush s'ka me mujt me e ndalë atë si ndërmarrje publike me pas një konkurrencë për me u marrë me

ndërtim. Për ata si fushëveprimtari e saj janë futur këto që janë ndërtime se unë e kam kërkuar një sqarim vetë e kam kërku kur ma kanë pru si dokument jena ndal në zyre i kena diskutu. Ky dokument domethënë i ka kaluar ato si drejtori po flas. Plotësisht pajtohem me ju që është dashur ndoshta me pas edhe një konsulencë edhe një diskutim, absolut nuk e menjanoj se s'jam kah du me kaluar diçka me thënë veç hajt se ne po do me kaluar, kjo bëhet për të mirën e qytetit.

Karanfil Haxhillari: Drejtor, po ligji për ndërmarrjet publike 03/L-087, e sqaron shumë mirë themelimin e një ndërmarrje të re publike lokale. Në qoftë se i referohemi ligjit që sqaron shumë mirë dhe në qoftë se e shikojmë raportin e këtyre ekspertëve në thojëza po ja them, kish mjaftuar veç një pyetje me ja ba komunës së Prishtinës që ka një ndërmarrje, e ka një ndërmarrje banesore publike banesore, veç e ka edhe një ndërmarrje tjetër të parkingjeve veç. Keni mund vetëm një, me kërku një konsultim qoftë me homologun tan Drejtorin e Shërbime Publike, atje i cili ka njohuri dhe ju kish qit në rrugë. A e din çfarë kundërthënë mes vete ka raporti i kësaj Res-publika grup edhe ligjit për ndërmarrjet publike. Veç po t'i theksoj disa sende: ndërmarrja më përpara në kundërshtim nuk qeveriset nga komuna, as nuk menaxhohet nga komuna, po menaxhohet nga bordi ndërmarrja publike, po nga bordi i drejtorëve. Pastaj, komuna para se me adresu kërkesën në njësinë për monitorim dhe politika të ndërmarrjeve publike, duhet me pas një plan të qartë të biznesit ku e garanton qëndrueshmërinë financiare të asaj ndërmarrje. Tjetra është planin e biznesit, nuk pash ndonjë strukturim të mirëfilltë se çfarë ka me bo kjo ndërmarrja publike! Pastaj duhet komuna në këtë rast vetë duhet të garantojë investimet e ardhshme për këtë ndërmarrje. Duke u bazuar të gjitha këto unë kam shumë dyshimet e mia a po kuptoni që jemi duke krijuar diçka në formën më të mirë të mundshme.

Çelë Lamaj: A e keni parë statutin e ndërmarrjes, a e keni material?

Karanfil Haxhillari: Po po e kemi materialin. Por është është kapet diku, del atje! Unë po e di se është edhe ligji për shoqëritë aksionare që i thekson qartë gjërat. Mirëpo ne si kuvend në fund të ditës drejtor, se si subjekt social demokrat e kemi qysh me thënë gjenezë, ne jemi për për krijim të ndërmarrjeve publike, por ama forma mua po më duket që në fund të ditës kemi me përfundu me zgjedh një komision komunal të aksionerëve, me i zgjedh nja pesë drejtorë të bordit dhe qaty me përfundu gjithçka. Shpresoj që të mos të jem gabim. Kur e përmenda ndërmarrjen publike banesor, për tregje që janë të kundërta. Komuna e Prizrenit drejtor i ka goxha namin e parkingjeve se thashë, goxha namin e parkingxeve që nuk kanë të bëjnë me banimin kolektiv. Parkingjet që janë përkaj banesave i përkasin atyre banesave. Pra ndërmarrja publike banesore menaxhon me ato që janë ato parkingje, por ama ndërmarrje publike për parkingje duhet me qenë e ndame e cila merret me menaxhimin. E thjeshtë bre nuk kemi me zbulou ujin e nxehtë, kemi të njëjta në Prishtinë, të njëjta i kemi. Ndërmarrja për parkingje është veç, ndërmarrja publike banesore është veç dhe këtu unë kam shumë dyshime të mia që kemi me kriju diçka abstrakte dhe kanë me përfundu një komision komunal i aksionarve, do anëtarë të bordit aty, ndonjë kryeshef, po çka më tutje, unë nuk kam kurgjë të qartë! Pra nuk kam një plan konkret, nuk kam, se kudo pikësynimi, këto kanë me t'i kërku edhe në njësinë për politikë dhe monitorim të ndërmarrjeve publike, kur ta bën kërkesën. Ku do me synu ti, cili është plani i biznesit, a ke ti kod buxhetor të ndam prej komunës që ti ke me mbështet këtë ndërmarrje, e shumë e shumë të tjera. Këto janë shqetësimet.

Çelë Lamaj: Unë mendoj, faza e parë do të jetë themelimi i ndërmarrjes. Pastaj janë procedura e procedura që thuhet që vjen deri te kjo, te ju. Më së pari, komuna që duhet të hartojë këto

dokumente pas miratimit të vendimit, konfirmimin e mjeteve financiare për mbas kësaj, themelimi ndërmarrjes, ndërmarrje publike banesore dhe parkingje si shoqëri aksionare, prefilimi i raportit të arsyeshëm për ndërmarrjen publike lokale, ndërmarrja publike banesore dhe parkingjet si shoqëri aksionare, plani buxhetor nga komuna e Prizrenit, ndërmarrje publike dhe parkingje Sha, plani i biznesit për ndërmarrje publike dhe skema e organizimit të ndërmarrjes, Domethënë krejt këto ne i dimë hapat. e mëtutjeshëm, domethënë mbas miratimit dhe mbas themelimit të ndërmarrjes publike atëherë ka me filluar për me u rregulluar dokumentacioni tjetër edhe kërkesat edhe atij planit të biznesit që e mendoni ju. Domethënë ne jemi konform ligjit për themelimin e ndërmarrjeve publike. Pse tash nuk i kemi nda, unë e di që Prishtina i ka parkingjet veç edhe kështu. Ne kena mendu që komuna e Prizrenit momentalisht, momentalisht menaxhon diku me nja 750 parkingje publike që mendojmë ne normalisht pas rregullimit të infrastrukturës në brendësinë e qytetit, po them e kemi idenë që të gjitha rrugë të cilat janë rrugë njëkajshe edhe ka gjerësi, profil të mjaftueshëm, njëra anë të bëhet të shfrytëzohet për parkim. Domethënë, hapi i parë për me funksionu kjo ndërmarrje ka me qenë parkingjet, ku të hyrat kanë me qenë prej tyre dhe ndërmarrja ka me u forcu, po kanë me qenë planet e punume në bazë të një renditje të kërkuara në bazë të ligjit. Kështu që ne nuk jemi me ndonjë hap të gabuar ose po bëjmë një dokument edhe në tash kemi me formu na nja tre akcionar, një bord drejtor dhe ka me ngel. Jo absolut s'jemi të interesuar për asi ndërmarrje. Ne jemi të interesuar me i menaxhu këto parkingje. Edhe Dafinës t'i përgjigjem që shumë shpejt kanë me filluar hartimi i projekteve për garazhime, premtime elektorale tonat, ku ne mendojmë që gjatë vitit në 2024 dhe 2025 komuna e Prizrenit kanë me ju shtua edhe nja 1000 parkingje të tjera, edhe nja 1.000 i kemi 2000 edhe nja 1000 të tjera nëpër qytet nëpër këto rrugë të tjera kena me pas 3000 parkingje ku njerëzit kanë me mujt me i fut makinat e veta. Këtë keni mu bind shënori kqyreni datën sot që është 4 marsi

Antigona Bytyqi: Bajrami fjalën e ka kërku.

Bajram Kastrati: Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë. Mirë që jemi të interesuar në përgjithësi për ndërmarrje, po unë jam i interesuar që fillimisht në seancë ta dëgjojmë edhe konsulencën me sqarime shtesë. Po gjithashtu jam i interesuar dhe secili asambleist ta merr tamam qartë se çka po voton. S'jam i interesuar me votuar në seancën e radhës menjëherë si si plan pa u shqyrtu. E tha Fili më herët ose Dafina dikush që duhet një konsult, konsultim publik së paku me asamblesë që ta dimë qartë se çka po votohet. Ne nuk jemi të njohur shumë që njihemi me ndërmarrje publike, marrim shembull qoftë Prishtinën, qoftë diku tjetër. Por paraprakisht është mirë me u konsultu, me pas një konsultim. Megjithatë jam i interesuar me dëgju edhe këto konsulent për sqarime shtesë në seancën e radhës.

Kujtim Gashi: A bënë unë një propozim drejtor? Një mes me gjetë. Masnesër është seanca, a mund që konsultim me pas nesër mbasdite?

Çelë Lamaj: Duhet veç me komuniku me ta edhe.

Bajram Kastrati: Po s'di pse duhet me u ngut kaq shpejt, pse patjetër ne në këtë seancë duhet me votuar edhe.

Kujtim Gashi: Jo a e di çku është problemi Bajram. Dilemat janë shumë të vogla që për me u shty qaq shumë kjo fare puna e pikës së rendit të ditës për shkak se këto janë do detaje të vogla. Kur po

flet Dafina edhe Fili për punën e ndërtimit edhe unë pak i kam do dilema dhe pse unë mendoj që ndërmarjet e kanë rolin e mirëmbajtjes, sepse ne e dimë që një pjesë e madhe e ndërtesave kolektive të na janë publike, nuk është tash ky model i ri që po i ndreqin privat. Por për shembull ortakollin ti e ke 100% publik e ka ndreq shteti. Edhe keto, edhe objektet tona për shembull kanë mbetur keq ato të Petrova atje familjet e dëshmorëve edhe ato janë publike ose ka dhe banesa të tjera. Në këto raste unë mendoj që ndërmarja e ka rolin e vetë edhe të mirëmbajtjes edhe me ndërru kulmin, liftin dhe me i rregulluar shkalët, domethënë ka punë ndërtuese. Tash veç kjo duhet pak a shumë me u definu. unë s'po mendoj që ndërmarja duhet me ndërtu banesa të reja por mirëmbajtjen gjithsesi e ka një prej punëve edhe rol të vetin. Këto janë do sqarime të vogla që nuk mendoj që duhet me hjek prej rendit të ditës. Por mundemi me pas nesër një konsultim të përbashkët me anëtarët e kuvendit që janë të interesuar.

Karanfil Haxhillari: Edhe një sqarim. Pra duhet të bëhet e qartë, ndërmarrja publike kryen shërbime, okej. çka përfiton, çka fut më tepër në projektet e saja për pasurimin e vetvetes është e mirëseardhme. Ndërmarrja publike duhet me kanë krahas shtesë i shërbimeve qoftë ato komunale qoftë çkado tjetër. Kërkush nuk po thotë që është kundër themelimit të ndërmarrjes, themelojmë ndërmarrje qysh duhet. Sepse ti në momentin që ndërtohet ndërmarrja publike banesore, nën një qajo ia lehtëson edhe Eko-rgjionit mirëmbajtjen e parqeve para banesave, ja lehtëson këtë rast eko-rgjionit edhe pastrimin që bëhet për skaj banesave, dhe është edhe një shërbim shtesë që i bëhet atyre banorëve aty. Njëjtë është edhe me parkingjet. Domethënë nuk ka nevojë me kontraktu komuna dikë privat, a po bëhet a s'po bëhet, çfarë po bëhet. Por është ndërmarrja që e shqyrton ma si për vete. Pra ne po duam, ideja jonë është me kriju diçka me tamon të bazuar në sende konkrete dhe ta dimë çka po bëjmë.

Çelë Lamaj: Qartë është, unë po them unë e kam shtjerru si drejtori komplet këtë, keni nevojë për nesër po e kqyrim ta bëjmë një takim mbasdite normalisht se mua më duhet mbas këtij takimi me i konsultu ata dhe për.

Karanfil Haxhillari: Shihe, këto në fund të ditës se tash ligji për ndërmarrjet publike thotë pa një miratim të qeverisë, në këtë rast njësisë për politikë a di nuk bëhet. Dhe tani që i kena konsultu, tash a doni me ju dhënë edhe informacion se i kemi konsultu shumë mirë rreth kësaj, e kemi ligjshmërinë e kësaj paraprakisht mos na kthehet. Se absolut unë e di që edhe ju s'jeni të interesuar si dokument me e fut na, mu kthye dhe me e përsërit edhe njëherë. Domethënë është shkuar komplet materiali edhe paraprakisht është diskutuar me ekspertë të cilët na kanë premtuar që ky është dokumenti i cili nuk ka arsye MAPL-ja, me na kthy.

Karanfil Haxhillari: Dije se qe ky dokument ka shumë të meta drejtor.

Çelë Lamaj: Po mirë tash, unë a doni konsulencën kam me ja u pru, e sqaroni janë jurista, janë njerëz të përgatitur për formimin e ndërmarjeve publike, ju sqaroj çdo gjë që keni nevojë ju me pyet.

Adem Shabanaj: Faleminderit, përshëndetje për gjithë. Po besoj që të gjithë këtu që jemi edhe të gjithë kuvendarët nuk janë kundër themelimit të ndërmarrjeve publike, por themelim në mënyrën më të mirë të mundshme. Mua po më duket që është pak e përshpejtuar si pikë e rendit të ditës sepse nuk është diskutu, të paktën kur janë pikat shumë të ndijshme, unë e di që ndoshta

ju e keni kuptuar komplet materialin edhe jeni konsultuar ndoshta me muaj derisa ka ardhur këtu si pikë e rendit të ditës por si drejtor dhe si drejtori ndoshta. Mirëpo çështja është te votimi, nuk vjen Drejtorja e Shërbimeve Publike me votu, e votojnë kuvendarët edhe po mendoj që është dashur të paktën me u konsultu me shefat e grupeve dhe duhet me u konsultu me shefat e grupeve për pikat të cilat janë pak më të ndishme e që janë në interes të përgjithshëm të qytetit të Prizrenit. Unë mendoj që asnjëri, as një subjekt politik nuk e refuzon një kërkesë të një drejtorie që është për të mirën qytetarëve. Edhe unë po besoj që edhe ndërmarrja publike banesore edhe parkingjet janë për të mirën e qytetit sepse po e dimë që parkingjet e qytetit të cilat janë pronë publike po shfrytëzohen prej qytetarëve të Prizrenit pa një rregullore pa një kriter pa një pagesë, e që po mendoj që është në dëm të komunës së Prizrenit.

Dafina Alishani: Jo pagesë po mirret privat!

Adem Shabanaj: Mua nuk më ka rastisur, por sidoqoftë. Po mendoj që është shumë më mirë me i nda këto, me i themelu dy ndërmarrje, me themelu ndërmarrjen banesore dhe për parkingje veç e veç, edhe te veprimtaritë atë që e cekti nënkrytari, po mendoj që është dashur të se kur themelohet ose një ndërmarrje ose një kompani private duhet të ceket në ARBK se cilat janë veprimtaritë e saj. Po mendoj që ndërtimi i ulët dhe i lartë është parë prej konsulencës si veprimtari, ndoshta edhe nëse nuk asnjëherë nuk në praktikë nuk veprohet prej ndërmarrjes publike po është dashur me u paraparë shkaku që gjatë rrugës mundet me dalë një ndërtim i vogël edhe ti nuk e ke veprimtarinë e asaj për me punu. Por duhet me pas kujdes sepse atë që tha Kujtimi, Nënkrytari që mirëmbajtja e objekteve banesore mos është veprimtari e veçantë edhe mos duhet me ju shtu si veprimtari ndërmarrjes publike për atë po them që po mos po ngutemi pak e po sa me themelu një ndërmarrje publike mos po duhet pak me e diskutu pak më gjanësisht edhe me me vendos atë që është më e mira për një ndërmarrje publike. Unë kisha propozuar që me me e shty si pikë të rendit të ditës për një seancë tjetër me i thirr shefat e grupeve me i njoftuar paraprakisht se çfarë po çka po bëhet dhe si po shkon, secili e jep atë mendimin e vet, sugjerimin e vet, edhe po besoj që është mi të mirën qytetare, sepse sot është drejtor dikush tjetër e nesër është dikush tjetër, po ndërmarrja publike mbetet. Për atë po po sugjeroj që me u shty si pikë e rendit të ditës, ndoshta me u diskutuar në seancë por mos me u marrë vendim e masanej me i thirr edhe shefat e grupeve ndoshta edhe ekspertë që janë të subjekteve politike me bë pak më pak më strukturum këtë farë këtë farë pune sepse ndërmarrjet publike e kanë goxha një rol të madh në nëpër qytetet ku veprojnë.

Çel Lamaj: Mendoj që ke pikë fut pikë e rendit të ditës.

Adem Shabanaj: Po është futur, nëse është qëllimi vetëm me e kaluar ajo ndoshta dhe kalon, po për me bërë diçka të mirë drejtor, unë e di që ti don me be të mirën, derisa të njoh që don me be të mirën po besoj që më mirëkupton në atë që e thashë. Me e nxjerrë më të mirën të mundshme derisa e qet në tavolinë, se në momentin që e qet në tavolinë ndoshta nuk e ke mundësinë edhe me e ndryshu diçka e nuk po besoj që duhet me u ngut kaq shumë sa që me gabu diçka gjatë rrugës.

Çelë Lamaj: Hartuesi i këtij drafti ose këtij statuti dhe kësaj rregullore për themelimin e ndërmarrjes publike ma merr mendja që ka me qenë aq i qartë që për një afat kohor një orë që ndoshta keni me mund me bërë pyetje dhe me kërku përgjigje prej tyre ka me ju sqaru krejt pse duhet të shtyhet tash ose të lihet. Keni me pas sqarimin, të njëjtin kena me thirrë edhe në kuvend që kuvendarëve përveç shefave të grupeve dhe në një grupi ndoshta e din kryesuesja më të gjanë

të këshilltarëve apo asambleistave të jenë prezent që nesër ta organizojmë, bëni tanat pyetjet e mundshme edhe unë jam për me u qartësu. Ne e dimë vetëm një që nëse një dokument e kalojmë këtu edhe nuk është përgatitur si duhet, MAPL-ja ka me na kthyer ligjshmërinë edhe nuk jeni të interesuar me na kthyer një dokument që të merrem edhe njëherë me të. Është shtjerë gjithçka që ka qenë bazë, se ka shumë pjesë juridike, unë jam jeni në dijeni qëjam me një profesion krejt tjetër. Mirëpo ata mua më kanë bindur, më kanë bindur që di me i lexum Karanfil edhe di me i kuptuar gjërat edhe më kanë bindur që ky është një prej dokumenteve i cili pa asnjë problem themelimi i kësaj ndërmarjes ka me pas implikime ligjore diçka që me na kthyer prej atje. Sqarimet tjera që duni me i pas, mua ma merr mendja, jo ma mermendja po është e saktë, se formimi i kësaj ndërmarje ku shkruhen këto veprimtari janë të futura në ligj, nuk është nuk është diçka që nuk është brenda ligjit edhe këta kanë shkruar fjali aty që duhet me mbaruar spitale, shkolla, objekte ose gjëra të tjera. Ato janë të përcaktuar decidivisht që një ndërmarrje publike mundet me pasur në kuadër të fushveprimtarisë vet edhe këtë që nesër ka me pas ku po e din ti që s'ka me i formu kjo ndërmarrje publike 200 punëtorë edhe ka me pas fuqi po që ka me konkuruar nesër në një projekt të mundshëm a këtu a atje a, që mos me ja ndalu atë. Po këto mundet me ja sqaruar shumë mirë konsulenca.

Karanfil Haxhillari: sje tuj na kuptuar drejtor. Qeky dokument shihe çka thotë për shembull, komisioni, kompetencat ekzekutive të aksionarve janë komisionit komunal të aksionarve thotë janë: ndryshimi dhe plotësimi i statutit, jo drejtor, nuk e bëjnë komisioni komunal i aksionarëve statutin, e bëjnë bordi i drejtorëve, gabim është kjo. Domethënë është statuti i ndërmarjes.

Bajram Kastrati: A ka për momentin statut.

Karanfil Haxhillari: Ama statuti nuk caktohet bre Bajram prej, nuk ndryshohet prej aksionarve. Pastaj thotë caktimi i anëtarëve të komisionit të auditimit, Jo bre, komisioni komunal i aksionarve në bazë të ligjit për ndërmarjet publike vetëm i përzgjedh dhe i mbikëqyr bordin e drejtorëve, të tjerat i bën bordi i drejtorëve. Domethënë këtu këtu kemi kundërshtime.

Çelë Lamaj: Këto sqarime ju thash ja u jep eksperti i cili ka bërë hartimin e këtij dokumenti.

Karanfil Haxhillari: Po të shkruame, këto ekspertët i kanë shkruar.

Çelë Lamaj: Po mirë more, ti ballafaqohesh me to, ballafaqohesh me to dhe i sqaron edhe.

Antigona Bytyqi: Atëherë pikën e nëntë po e hedhim në votim që t'i rekomandohet mbledhjes së ardhshme. Kush është për? katër jemi për, dy kundër. Atëherë edhe pika e nëntë i rekomandohet mbledhjes së ardhshme. Kalojmë te pika e dhjetë.

Pika e dhjetë:

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të datës 31 dhjetor 2022, për këshillin e fshatit Zym.

Antigona Bytyqi: Besoj që e keni parë që është puna për pagesa.

Karanfil Haxhillari: çka tash, kush mundet me sqaru?

Antigona Bytyqi: Këta tash që është paraparë me u paguar 50€ të gjitha komitetet, të gjitha komitetet e tjera përveç komiteteve obligative sipas ligjit të ri po thotë që nuk duhet me u pagu. Kurse këto parashihen me ligjin e veçantë siç e dini edhe Këshilli i Qendrës Historike edhe i Zymit po ashtu edhe në komunën e Rahovecit siç është fshati Hoqë e Madhe. Edhe tash jemi tuj u munduar se momentalisht nuk janë tuj u paguar, domethënë asnjëri këto këshilla edhe thotë anëtarët do të kompenzohet thotë konform nenit shtatë të rregullores për kompenzimin dhe funksionimin.

Karanfil Haxhillari: Që thotë kryetari 30% të zyrtar financiar edhe 20%. E sa i bjen kjo?

Antigona Bytyqi: i bjen 200 e diçka. Është propozuar kjo pikë atë ditë në takimin me shefatin e grupeve.

Karanfil Haxhillari: Punë të madhe po bëjmë ata për me marrë pare.

Egzona Hoxhaj: Përderisa e ka Këshilli i Qendrës Historike.

Bajram Kastrati: Për këtë e keni regulluar apo?

Antigona Bytyqi: Për ato e kemi ba plotësim-ndryshimin.

Dafina Alishani: Unë s'di asamblistat tonë ndonjë punë a e kanë kryer, është që angazhohet një Lajde, dyqysh qeky komision merr kot pages po flas për anëtarët tanë. E tash lufta e madhe për pagesë e mos me pas asnjë punë në shesh plus tash nuk bën me bo që kaq hugjum për pagesa, pagesat na kanë rregulluar asambleistave është marre tan ato komisione pa pagesë, është marre tash me i dhënë qekaq zor veç për me pas një shtesë!

Egzona Hoxhaj: A muj veç pak mu ndërlihd. Okej, në fakt te çështja e asambleistave pajtona dhe unë plotësisht me juve çka i thatë, ama aty anëtarë në atë komisionin janë edhe tre vetë që janë të Zymit edhe ata krejt këtë punë po e kryejnë edhe sinqerisht ju duhet një mbështetje për me mund me realizu aktivitetet. Për shembull është Tereza, është Lajdja edhe është ai Mehmeti nëse nuk gaboj as po e di emrin saktë, Muharremi. Ata janë tan kohën aktiv sa i përket aktiviteteve edhe këtyre. Është e vërtetë që.

Kujtim Gashi: Problemi është që nëse ky vendim për Këshillin për Qendrën Historike e merret, ky është ekuivalent tani edhe për këshillin tjetër. Domethënë se roli është i njejtë edhe trajtohet me një ligj të njejtë, nuk mundesh me bë dallimin. Tash problemi për çka na duhet me zgjidh problem është Këshilli i Qendres Historike.

Karanfil Haxhillari: Jo jo, këtu po shkruan për këshillin e fshatit Zym të Hasit.

Antigona Bytyqi: E kemi kryer për këshillin.

Bajram Kastrati: Për Këshillin e Qendrës Historike e kemi kryer më herët.

Kujtim Gashi: ti obligoesh tash me ja bë edhe atyne.

Egzona Hoxhaj: Po saktë. se ata po paguhen.

Karanfil Haxhillari: A duhet me një vendim të veçantë a?

Antigona Bytyqi: Ne jemi duke bërë veç plotësim-ndryshim se që është paraparë 50€.

Karanfil Haxhillari: Se nuk ka kuptim për shembull, komisioni për themelimin e bashkësive lokale, 40 bashkësi lokale duhet me i themelu dhe nuk paguhet asnjë cent a po kupton. Kurse këta qysh ka me u pagua?

Bajram Kastrati: Pse a s'po paguhen këshillat lokale?

Karanfil Haxhillari: Jo bre komisionet komunale s'paguhan asnjë. Kryetarët e bashkësive lokale po, komisioni jo.

Dafina Alishani: Mandej edhe një pyetje e kam. Ne kemi votu në kuvend për me u formu zyra për trashëgimi, suformu hala! Tash knej kur po ka meditje po i japin zor, a knej është një zyrë e cila ish dasht me u formu prej kryetarit e ndoshta edhe i kish shty këto sene përpara. Zyrën has, zyrën këtu qendrën historike. A e din mua po më duket njëfarë pazarxhillëki veç për meditje. Nuk po e kontestoj aktivitetin e këtyre, unë kam respekt qysh e patë emrin ai zotria që erdhi herën e fundit, ai u ankojte që s'po i vijnë anëtarët, e valla mos me shku si anëtar, ke buruar prej kuvendit i ki 700€ apo 600€ rrogën, hajde heqi këto 600 euro rrogën edhe hala je ka shtyhesh është marre. Unë ja them edhe kuvendarëve që janë se s'janë të angazhuar. A veç 70 vjet i kish njeri qetu u ankua tha s'po më vijnë asnjëri.

Egzona Hoxhaj: Për atë edhe unë thash se takimet po i mbajnë ata brenda përbrenda dhe po i vazhdojnë punët.

Bajram Kastrati: Për këshillin e qendrës historike a është marrë qeky vendim?

Antigona Bytyqi: Po.

Bajram Kastrati: A ka filluar me u zbatu?

Antigona Bytyqi: Deri tash nuk është zbatuar.

Dafina Alishani: Arsyeja?

Kujtim Gashi: Arsyeja, ka problem pak në Ministri të Financave, s'po e ekzekutojnë.

Bajram Kastrati: a mundet me pas edhe ky të njëjtin problem?

Kujtim Gashi: I njëjti fat e përcjell edhe këtë, pikë për pikë.

Bajram Kastrati: Na veç me i kry formalitetet.

Egzona Hoxhaj: Mos me na ra neve në qafë ata po e bëjna.

Antigona Bytyqi: është kërkesë e vazhdueshme edhe atë ditë në takim me shefat e grupeve është propozu. Qe edhe Blerimi na sqaron.

Blerim Rakaj: Vendimi për pagesën e këshillit është nxjerrë tuj u bazu në rregulloren për kompensimin për detyrat shtesë dhe e parasheh aty mundësinë e pagesës. Ministria e Financave pa ndonjë vërejtje për mungesë të dokumentacionit ose diçka tjetër, thotë se paguhen vetëm dy komitetet obligative dhe nuk jep një sqarim pse nuk paguhen. Aktet juridike i ka nxjerrë Ministria e Punëve të Brendshme dhe nuk lejon pagesën Ministria e Financave.

Dafina Alishani: Blerim, ngom kontradiktën që mua s'ma lejon karakteri me votu. Këtu po votojmë na për kompensimin dhe funksionimin shtese. Këta s'po funksionojnë jo shtesë por pa shtesë po funksionojnë, s'po shkojnë në mbledhje.

Blerim Rakaj: Unë po flas vetëm për pjesën e vendimin.

Dafina Alishani: Qysh me ja pagu funksionimin shtesë kur një asambleist nuk shkon me një komision që është i votum edhe që e ka obligim me marrë pjesë!

Karanfil Haxhillari: Kur të paguhe mandej shkojnë.

Bajram Kastrati: Kush ka thënë që s'po shkojnë.

Adem Shabanaj: Ai i fshatit Zym.

Bajram Kastrati: Shtjefën Dulaj, ai ish që ka qenë.

Dafina Alishani: Së fundmi, na skena pas raportim tjetër.

Bajram Kastrati: Mirë është me pas edhe një raport.

Dafina Alishani: Po s'ka punë, unë në Prizren po nij për Has që s'ka punë.

Antigona Bytyqi: E kemi në plan të punës, besoj që vijnë me na raportu.

Bajram Kastrati: tek e fundit e kërkojmë një raport.

Blerim Rakaj: Nëse më lejon vetëm pjesën procedurale ligjore sipas rregullores. Këto nuk janë të punësuar e as nuk janë në marëdhënie pune me komunën e Prizrenit një pjesë e anëtarëve. Ndërsa pjesëmarrja e tjerat se di a shkojnë a nuk shkojnë.

Dafina Alishani: Me ligj të ri, tash edhe qet pyetje e kam. Një asambleist, jo një asambleist por një qytetar nëse është i paguar prej qeverisë, nëse merr rrogë e merr veç 30% e rrogës së dytë.

Blerim Rakaj: Vetëm shtesë, për funksion shtesë, këto nuk janë të punësuar në komunën e Prizrenit, janë të angazhuar.

Dafina Alishani: Dy asambleista i ke të punësuar në komunë edhe janë në komision të angazhum.

Blerim Rakaj: Të angazhuar.

Dafina Alishani: Kallxojini që veç 30% i marrin edhe nuk e shtijnë si rend të ditës.

Blerim Rakaj: 30% është të pagës bazë të kryetarit për një muaj si meditje.

Dafina Alishani: A po më kupton çka po pyes. Unë jam asambleiste, punoj edhe me një punë tjetër shtetore, 30%-shin e marr prej pagës së dytë, tash kjo po bëhet paga e tretë, s'ka kuptim bre kryesuese.

Blerim rakaj: Kjo parashihet pagesa për angazhim shtesë.

Dafina Alishani: çfarë shtese bre, kto s'janë tuj shku në mbledhje.

Antigona Bytyqi: S'mujmë me ditë a po shkojnë a s'po shkojnë.

Bajram Kastrati: Ja, ky komisioni i ri ka mundësi janë tuj mbajtë mbledhje, ai ka folë për të kalumen Shtjefën Dulaj.

Kujtim Gashi: A ka të drejtë Dafina, plotësisht. Por, problemi është që ky vendim është i përfshirë në mënyrë ekuivalente edhe për atë këshillin tjetër, a halli është me këtë këshillin këtu të Prizrenit sepse qeky i shqyrton lëndët përditë. Paraprakisht kalon nga ata tani kthehen në Drejtori të Urbanizmit për mu marrë leja.

Bajram Kastrati: Atë të këshillit Prizrenit e kemi kry.

Kujtim Gashi: po tash ti obligohesh ata mi kry. Është e vërtetë që ata s'kanë punë sepse aty asnjë leje nuk mirret.

Dafina Alishani: Ose si qeverisje po ju lus, prodhoni diçka delegojani naj punë sepse sinqerisht po flas është marre tan ky buxhet mu shfrytëzu edhe kurgjo mos mu ba, le të përfiton Hasi se për qatë u ba. Hajde këtu, hajde në kuvend merr pagë, hajde në komision merr pagë, në fund të ditës nuk ki kurgjo që ke qitë në dritë. Unë s'maj në mend që një asambleist që është i angazhum në qet komision me ngritë naj shqetësim në emër të qetij komisioni.

Çelë Lamaj: S'ka pasur shqetësime ndoshta.

Egzona Hoxhaj: Jo shqetësime ka boll.

Dafina Alishani: Jo por së fundmi, mua më ka ardh keq njeri 70 e kusur vjeç erdh qetu me raportu edhe thojke amani ju koftë ndërroni qeto asambleista se s'po vijnë në mbledhje.

Bajram Kastrati: Na të njëjtit i kemi qu prap mduket.

Kujtim Gashi: Me më pyet mu, ky këshill s'duhet me egzitu hiç as ky as ai.

Dafina Alishani: Plus ti e di më herët qysh ka funksionu.

Kujtim Gashi: Problemi që kjo është prej pakos së Ahtisarit, na ka mbet këtu një farë rremi na ka mbetur.

Bajram Kastrati: Nuk punojnë ata jashtë kompetencave Dafina.

Kujtim Gashi: Përndryshe absolutisht ata s;kanë rol.

Bajram Kastrati: Qatë de Dafina nuk punojnë ato jashtë kupetencaave.

Dafina Alishani: Singerisht po më vjen shumë keq, mua më vjen keq për ata që angazhohen vullmentarisht, po kjo është keqpërdorim bre.

Çelë Lamaj: A ka sanksionim nëse ai anëtari i komisionit një herë, dy herë, tre herë nuk ka.

Dafina Alishani; Jo qfarti, ata as kërkush që i bënë.

Kujtim Gashi: Ata shkojnë e qesin nënshkrimin, rijnë nja pesë minuta e kanë mbajtë mbledhje, qysh ndodh shumë.

Bajram Kastrati: Jo more, i kërkojmë raport tek e fundit i kërkojmë raport.

Antigona Bytyqi: Thash e kemi në plan të punës, por nuk e di cilin muaj, po gjatë vitit duhet me ardh me raportu.

Dafina Alishani: Gojen plot e kam për has, kur vjen puna mu angazhu nuk shkon në Komision.

Antigona Bytyqi: Atëherë nëse s'kemi diçka tjetër po e hedhim në votim pikë e dhjetë që ti rekomandohet mbledhjes. Shtatë jemi prezent, kush është për që pika e dhjetë ti rekomandohet mbledhjes së ardhshme? Katër jemi për, kundër, zero kundër dhe tre abstenim, faleminderit. Kalojmë te pika e njëmbëdhjetë.

Pika e njëmbëdhjetë:

Shqyrtimi dhe miratimi i propozimin-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të datës 04 maj 2023,

Antigona Bytyqi: Për stacionin e autobuseve është fjala, po ashtu edhe kjo pikë atë ditë në takimin me shefat e grupeve është propozuar që të hyj në rend dite edhe kemi parapa.

Dafina Alishani; Kush është sponsorizues? Diçka e kena harru qet veti që kur ka sponsorizues të pikave me qëndru në KPF.

Blerim Rakaj; është propozuar në takim me shefat e grupeve.

Adem Shabanaj; Për zëvendësim.

Antigona Bytyqi; është fjala për zëvendësimin e anëtarit z. Krasniqit meqë është emëruar drejtor.

Dafina Alishani; Kush e ka, cila drejtori e ka themeluar këtë Komision.

Blerim Rakaj; Kuvendi e ka themeluar këtë komision.

Çelë Lamaj; Ju e dini që janë 3 aksionar, njëri u ba tash drejtor edhe duhet mu ba zëvendësimi i qatij drejtorit.

Dafina Alishani; Në qet ndërmarrje nuk të hec fjala, s'ki ti je dikun tjetër.

Çelë Lamaj; Më hec më hec, se din ti hala, hala se paske krejt informacionin.

Kujtim Gashi; Me ju njoftu, ministria ka kthy një përgjigje se di a keni pa, por s'ka thënë sen! E ka marrë nenin. e ligjit për ndërmarje publike e ka qit kopje dhe e ka çu, s'ka dhënë asnjësqarim! Tash është në dorën e juaj a e ndërroni, a e leni.

Karanfil Haxhillari; Dy thotë, i përzgjedh kuvendi komunal, një e përcakton kryetari, e delegon kryetari i komunës, shumë qartë është.

Bajram Kastrati; Po a thotë kuvendi komunal, kuvendar apo veç kuvendi komunal.

Kujtim Gashi; Qekjo është e paqartë.

Bajram Kastrati; Na me pas qenë pak më të qartë edhe herën e kalume, ndoshta edhe nuk i kishim përzgjedhur kuvendar po kishim përzgjedh dikë nga jashtë më ekspert më, fjala bie. U dashtë me qenë të informaar ne dhe më herët që a përzgjidhhen kuvendarët apo jo.

Antigona Bytyqi; Na kemi shku sipas praktikës.

Karanfil Haxhillari; Praktika gjithandej Kosovës për komisionin komunal të aksionarve kanë shkuar domethënë prej kuvendarëve.

Bajram Kastrati; Atëherë po shkojmë me praktikë.

Antigona Bytyqi; Po pikërisht.

Adem Shabanaj: Me praktikë ne kemi shku edhe me praktikë është zgjedhë komisioni po tash është dilema e Simirit që është ba drejtor.

Kujtim Gashi: Edhe atë e ka zgjedh kuvendi.

Egzona Hoxhaj: Atëherë ka qenë asambleist

Karanfil Haxhillari: Kur bëhet ekzekutiv, kalon në ekzekutiv.

Adem Shabanaj: Nuk është më pjesë e kuvendit nëse i referohemi praktikës.

Kujtim Gashi: Ama veç kërkush s'po thotë aty që kuvendi nuk mund me zgjedh një prej ekzekutivit, as s'po thotë prej legjislativit, legjislativi po thote dy i emëron.

Bajram Kastrati: Nënkryetar, nëse kemi shkuar ne me praktikë që me i përzgjedh kuvendarët atëherë duhet me vazhdu me u përzgjedh kuvendari. Tash ne herën e kaluar.

Egzona Hoxhaj: Ajo e ekzekutivit qysh po thotë edhe Fili po po caktohet se po thotë prej ekzekutit.

Kujtim Gashi: Jo Jo, thotë e propozon kryetari se defionon as aty edhe dy kuvendi se defionon.

Bajram Kastrati: e përzgjedh kryetari edhe dy kuvendi.

Antigona Bytyqi: Te kjo nuk e defionon edhe thotë e emëron kuvendi. Kemi raste komisione të tjera thotë duhet të jetë anëtar i kuvendit, e specifikont e kjo nuk është për atë ka qenë kjo dilema që a ka mundësi ai me vazhduar apo? Ne qysh e kemi bë pyetjen e kemi bë copy past nemin e kemi ba pyetje specifike dhe kemi dashtë përgjigje a mundet me vazhduar apo jo? Edhe vetëm atë e ka kopju referoju unë këtij neni.

Dafina Alishani: Tash sa mund bre një drejtor i shëndetësisë me u angazhuar në ndërmarrje të stacionit, veç me ba naj infuzion.

Bajram Kastrati: Tash na s'kemi çka me ba, po e vazhdojna praktikën e mëhershme. Propozoj që me vazhdu me praktikat, mu përzgjedh një kuvendar.

Antigona Bytyqi: Po e hedhi në votim edhe pikën e 11-të, kush është që ti rekomandohet kuvendit.

Bajram Kastrati: Veç diçka, kemi diskutuar edhe herën e kaluar se e keni pas bë me çlës ju atëherë, e tash unë e kam ndërruar pozicion. Prap jam në atë mendimin që s'kemi nevojë me bë me qelëles., unë s'jam pajtu edhe kur kam qenë në pozitë.

Kujtim Gashi: Bajram, vullneti për ndërmarje ka qenë një me qenë i qeverisë, një i opozitës.

Bajram Kastrati: Mirë de, ka qenë vullneti i shumicës por jo edhe jemi.

Antigona Bytyqi: Po po, ti ke qenë kundër.

Bajram Kastrati: Unë kam qenë kundër edhe vazhdoj me qenë prapë kundër kësaj praktike, pse? sepse po bëhet, përnjëmend po bëhet shkelje, atëherë kam thënë dhe prapë vazhdoj me thënë po bëhet shkelje e demokracisë. Ne kemi mund me i përzgjedh dy të pozitës atëherë ose dy të opozitës, kuvendi i përzgjedh, aty edhe ligji po thotë kuvendi e përzgjedh.

Antigona Bytyqi: Po edhe ajo nuk është shkelje, një prej opozitës, një prej pozitës.

Bajram Kastrati: Mirë de, shumica tash të mundin, vetëm jam kanë atëherë vetëm jam tash.

Kujtim Gashi: Ta rrespektoj mendimin pasi e ke pasur edhe atëherë qeshtu.

Bajram Kastrati: Kam qenë parimor edhe vazhdoj të jem.

Antigona Bytyqi: Në qoftë se nuk kemi diçka?

Karanfil Haxhillari: Jo, na anëtarin e kemi aty.

Dafina Alishani: Komuna e Prizrenit, e ka kryetarin e në frymë të amerikanëve dhe qeverisjen e mirë du me pas edhe prej opozitës, a po foli mirë?

Karanfil Haxhillari: Le moj se këtu e kemi vendosur, çfarë kryetari.

Egzona Hoxhaj: Kjo është meritë e jona që jemi dakordu këtu.

Bajram Kastrati: Megjithatë kryetari megjithatë prapë ka mu mundësi me pas kryesuese, prapë ka mu mundësi me pas propozime të tjera aty që nuk ju ndalohe.

Antigona Bytyqi: Nëse ka i qesin, ai që mer votash shkon. Tash për me qe korrekt në qoftë se dojmë me qenë korrekt duhet me ja lënë pozitës ose subjekti politik që e ka pas.

Bajram Kastrati: S'di korrekt, ka kohë që në politikë s'kam dëgju këtë fjalën për me qenë korrekt, por sidoqoftë.

Antigona Bytyqi: Politika është politikë, por po mendoj që disa parime, disa qëndrime duhemi me i respektu, sepse i kemi nxjerrë vetë.

Bajram Kastrati: Unë thashë, kam qenë parimor e vazhdoj të jem parimor prapë. Kështu që ka mundësi kam me pas propozime të tjera, nuk e kam me tendenca as se kam pas herën e kaluar për veti, por po mendoj që është shkelje.

Antigona Bytyqi: Nëse ka më shumë i qesim në votim.

Dafina Alishani: Veç që ki me ja prish gjumin Kujtimin e mu angazhu për këto sene.

Kujtim Gashi: disa ditë s'jam këtu, po u duka me nejtë.

Antigona Bytyqi: Kush është që pika e 11 ti rekomandohet mbledhjes së ardhshme? Gjashtë jemi për, zero, kundër dhe 1 abstenim. Rekomandohet atëherë edhe pika e 11 mbledhjes së ardhshme. Kalojmë te pika e 12-të., Tash për këto pika, në qoftë se doni diçka me diskutu, drejtori i sqaroji në fillim. Po drejtor tu kisha lutur me i përmbledh për 13 pikat, mandej veç i qesim në votim.

Dafina Alishani: Edhe këtko të Dejtorisë së Shërbime Publike a? Mshelni drejtoritë tjera.

Bajram Kastrati: I kemi pa në posttim të Petritit.

Çelë Lamaj: Kjo kjo kërkesë ka qenë e Ministrisë Planifikimit dhe Ministrisë së Kulturës që këto 13 objekte të futen në mbrojtje. Normalisht që janë kërkesat e tyre, janë identifikuar prej tyre krejt këto monumente në kuadër të territorit të komunës së Prizrenit. Kërkohet që kjo. Listë prej 13 të kalojë në kuvend, normalisht edhe të merret edhe një miratim i ministrisë pushtetit lokal. Nëse keni nevojë për sqarime, na kanë thënë ekspertë apo njohës të kësaj fushe prej ministrisë e vijnë edhe ja u sqarojmë në seancën e kuvendit, nëse keni nevojë me pas sepse ishin disa trungje, vjetërsia e tyre, hapësira e krejt. Domethënë mes ligjit për mbrojtjen e këtyre monumenteve që janë përcaktuar.

Kujtim Gashi: Unë veç pak kështu me me ndihmu, se këto janë të paraprame me ligj, është analoge e ligjit për trashëgini kulturore, domethënë objektet që futen në mbrojtje në listën e përkoshme dhe të përhershme edhe një pjesë e këtyre pasurisë natyrore që identifikume, domethënë trajtohet me këtë ligj. Të gjitha këto janë analizë e hershme edhe mirë që po hyn, se zakonisht kanë ditur me u dëmtuar gjatë kohës, ose i ka dëmtuar vetë natyra ose faktori njeri. Por janë domethënë monumente të rëndësishme për mbrojtje.

Karanfil Haxhillari: Ku është me pasë sa më shumë monumente. Në rregull, shko në paketë bre.

Antigona Bytyqi: Domethënë prej pikës 12-24. Atëherë po i hedhim në votim, prezent jemi gjashtë anëtarë. Kush është për? unanimisht, faleminderit. vazhdojmë me pikën 25.

Pika e njëzetë e pesë:

Vazhdim i diskutimit të raportit për gjashtë mujorin e dytë të kryetarit të komunes.

Antigona Bytyqi: Nëse s'keni diçka me shtu po e hedhim në votim. Kush është për? unanimisht. Kalojmë te pika 26.

Pika e njëzetë e gjashtë:

Raporti financiar për priudhën tetor-dhjetor 2023

Antigona Bytyqi: Edhe këtë me sa e di e kemi diskutuar. Kush është për? unanimisht faleminderit. Kalojmë te pika e 27-të.

Pika e njëzetë e shtatë:

Raporti për zbatimin e planit të integritetit në komunën e Prizrenit për vitin 2023

Antigona Bytyqi: Kush është për? Unaranisht, faleminderit. Raportin e performances i larguam dhe raporti i punës së kuvendit. Kemi mbetur te pika e 31. Kush është për që të rekomandohet mbledhjes së ardhshme? Unanimisht, faleminderit. Edhe e kemi propozimin pikën e drejtorit për vendosjen e reklamave në territorin e komunës.

Pika e rendit të ditës:

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për vendosjen e reklamave në territorin e Komunës së Prizrenit;

Antigona Bytyqi: A keni ndonjë pyetje?

Çelë Lamaj: Faleminderit Kryesuese. Në mbështetje të nenit 17 pika b) të ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës numër 28/2008) dhe nenit 20 pika dy e Statutit të komunës së Prizrenit numër 01/011-5643 të datës 15-10-2008, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.4 të Ligjit mbi qendrën historike të Prizrenit, se këtu ka me pas edhe reklama, por normalisht që asnjë reklamë nuk ka mujt me ka me u vendos pa pëlqim prej tyre, normalisht ata i kanë rregullat e veta, e japin mirë se japin, ne i kemi caktuar si Drejtori e Shërbimeve Publike së bashku me Drejtorinë e Urbanizmit të gjitha këto lokacione ku ne mendojmë që mund të vendosen këto reklamat si bilborda edhe reklamat e shtyllat elektrike në territorin e komunës së Prizrenit,. Këtu i keni përcaktuar me të gjitha lokacionet me lista të përcaktuara, kemi materialin të kompletuar, është bërë një dizajn edhe për këto e kemi në kuadër të drejtorisë si material dizajni i përafërt. Mirëpo ky dizajn normalisht se drejtoria për çdo lokacion ka me aplikuar për leje në Drejtorinë e Urbanizmit, ata duhet të jetë ata të cilët kanë me i përcaktu formën madhësinë e një në bazë të lokacionit të cilin lokacion do të vendoset, se cila reklamë mundet me u vendos aty, lloji i reklamës edhe madhësia, dimensionit i asaj reklame.

Dafina Alishani: Se di a dini, por asnjë reklamë nuk ka leje momentalisht në qytet, këto ekranet e mëdhaja që janë duke e shëmtu secilën lagje, nuk ka leje asnjëra. Që doni këqyrni në urbanizëm, cila prej reklamave. Unë vetë kam aplikuar për leje, e vetmja jam që kam aplikuar për leje të reklamës para pesë viteve.

Çelë Lamaj: Kjo te stacioni më kanë thënë që ka, më kanë thënë mua sepse se kemi drejtorin e urbanizmit këtu me na tregu.

Dafina Alishani: Veç edhe diçka drejtor. Ki banorë të lagjeve sidomos prej këtyre ekraneve që kanë shumë ankesa, nuk ka as rregullore qysh duhet me qenë, as ai lloj ndriçimi, ai ndriçimi ta rrezikon ty edhe vet si vozitës. Nuk jemi absolut kundër këtyre, por veç po them që jeni duke bërë një kaos duke e dit tuj bë kësi lloj vendime. Te ligji i qendrës historike, nuk po respektohet ligji për qendër historike, ti i din shumë mirë qysh janë dimensionet, asnjë reklamë nuk është heq deri tani prej qendrës historike, as nuk ka kurrëfarë kriteri, QRTK-ja rekomandon, inspektoriati fajëson QRTK-në edhe vazhdon një kaos i tërë në qytetin, në qendër të qytetit.

Çelë Lamaj: Edhe ne si drejtori kur kemi marrë këtë hap, një prej arsyeve ka qenë që ka shumë reklama të cilat vendosen vend e pa vend, disa prej këtyre ekranave të mëdhenj, kam një informacion po nuk mund t'jua dokumentoj se duhet Drejtoria e Urbanizmit a kanë leje apo s'kanë leje, për disa e di, që ka leje ky, s'ka leje ky. Për ata kjo kishte me qenë zgjidhja më e mirë për

qytetin e Prizrenit, njëherë për gjithmonë, këto janë lokacionet, këto kanë me menaxhu se janë lokacionet publike, normalisht prej drejtorisë. Çdo tjetër, ndonjë lokacion për objekte private që kërkohet është me siguri Drejtoria e Urbanizmit se ka një farë rregullore me të cilën mundet me dhënë një reklamë apo jo.

Dafina Alishani: Nuk ka.

Çelë Lamaj: Nuk e di, nëse s'ka atëherë ata duhet me i pa krejt ato leje kush i ka dhënë ato leje edhe me shku në përgjegjësi.

Dafina Alishani: Nuk ka leje.

Çelë Lamaj: Ka leje, unë po ju them që ka leje për vendosjen e reklamave në qytetin e Prizrenit, nëse ata klauzulën e tyre nuk e kanë bazuar në ligj, atëherë çka është kjo vepër penale. Qysh mundesh me dhënë ti një leje për një objekt privat, se ne nuk intervenojmë, ju e dini se Drejtoria e Shërbimeve Publike merret vetëm me pronën publike, ku ne mund të japim pëlqime, po nëpër objekte private kanë kërkuar prej nesh t'i pajisim me pëlqim, po unë në një shtëpi private unë nuk ndërhyj që është pjesë e urbanizmit a e lejon apo nuk e lejon.

Dafina Alishani: Unë po të siguroj drejtor rrugën Tirana, ku janë qendra tregtare vetëm një subjekt privat e ke me leje edhe ato më kanë thirrë me pyet qysh bëhet leja? Leja e vetme ka qenë 01, domethënë leja e parë. Unë kur kam shku kam thënë qysh i kam marrë këto objekte të tjera, ekranet e mëdhaja që janë këto, asnjëra, këto temat këto të mëdhaja, asnjëra s'kanë. hiç, hiç, hiç. Hyni këqyrni bashkë me urbanizmin, nëse e gjeni me leje.

Çelë Lamaj: Unë mendoj se këto i merr përgjegjësi, Drejtoria e Shërbimeve Publike nuk ka me mujt asnjë lokacion.

Karanfil Haxhillari: Veç edhe një pyetje, çfarë reklama kanë me kanë, çfarë dimensione, çfarë?

Çelë Lamaj: Janë të përcaktuara, ne kemi bërë dëgjao. Ne kemi bërë një dizajn që ne mendojmë, se janë disa arkitektë aty që në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanizmit janë dalë edhe kanë bërë një dizajn se çfarë munden me qenë si dimensione se tash kjo ka me qenë një elektronikë e cila ka me i përcaktuar kompania e cila ka me qenë përfituese por me karakteristikat tona me madhësitë të cilat kanë me u leju nesër me u marrë leje. Por ka me u marrë leje lokacion për lokacion edhe urbanizmi ka me qenë përcaktues a ka me qenë një me një a gjys metër apo ka me qenë katër me pesë ose tri me dy. Në bazë të një rregullore që e di që e ka urbanizmi që unë e kam kërkuar vetë për me e parë për një reklame në qytet maksimumi thotë në rregullore të urbanizmit thotë që është 3 me 2, pra është 6 m² reklama më e madhe e matse lejohet me rregullore, se ka pas kërkesa tre me katër, çka ta di unë që i kalojshin ato përmasa, maksimumi është thotë 3 me 2 m, pra 6 m² është maksimumi i një reklame. Për këto në qytet krejt ka me u nvarë prej lokacionit madhësia tyne, dizajni mundemi me, ajo ka me qenë publik se kur hapet procedura tenderuese e saj, ka me u tregu se me çfarë dizajnesh të madhësive duhet me konkuru ata, ata kanë me konkuru. Por për çdonjërin, këto ka me shku ne mendoj, së paku ne mendojmë se kjo duhet me shku me njësi, jo me na prezantu ata. Na mendojmë që në këto lokacione se kjo është një investim goxha i madh, nuk ishte investim që mundet me u bë për një vit, kjo është një kontratë tre vjeçare edhe ne kemi

me i pa prioritetet si komunë, jo çfarë don ai me qit ose ku don ai ose në çfarëdo vendi don. Ne i shohim prioritetet se ku duhet të vendosen ato edhe qyteti është keq sepse kudo po vendosen reklamat nëpër rrethrotullime nëpër hapësira gjithkush ka vendos, disa herë ka vepruar inspektoriati dhe i ka larguar pas tre ditë apert vendosen e kjo ka me i parandaluar që operator në mënyrë ilegale të na qesin reklama të ndryshme nëpër qytet.

Karanfil Haxhillari: Po prapë ishin parara në rrothrotullime bile me quditi një përballë xhamisë Sinan Pashës ish përcaktu.

Çelë Lamaj: Dëgjo, tash ne i kemi paraparë krejt tash përballë xhamisë së Sinan Pashës, qendra historike, ligji mbi qendrat historike thotë lejohet reklama në 1 metër katror, i trajton, edhe të kallzon materialet, a duhet e drurit me qenë, a duhet e hekurit, a ka mundësi me pas ndonjë ndriqim a s'ka mundësi a, nëse do dikush me pas një reklam, ajo ka me i përcaktu edhe reklamat e dyqaneve, s'kanë nevojë dyqanet me vendos tashi gjithçka në zonën historike.

Dafina Alishani: Po e dimë bre ligjin o drejtor.

Çelë Lamaj: Po mirë, ajo kjo nuk, me këtë me këtë vendim, ka me u futur në rend qytetari, ka me dit që nesër kur të apikon në urbanizëm se po e di që shkon me ligj.

Dafina Alishani: Po përtej ligjit kush mundet me fut në rend qytetarin, ligji s'po respektohet!

Çelë Lamaj: Në moment që ne të fillojmë me kërkun si institucion leje prej qendrës rajonale për trashëgimi kultore për vendosjen e një reklame dhe ata kanë me i hapur sytë pak më shumë edhe kan me kqyr edhe inspektoriatit ka me ju dërgu që nuk lejohen reklama tjetërkah përveç këto lokacione të cilat janë parapa.

Dafina Alishani: Po ligji të obligon edhe ty edhe QRTK-në, jo vendimi. Ligji a është mbi të gjitha.

Çelë Lamaj: Tjetra, qendra rajonale për trashëgimi kulturore e cilia është departamenti i ministrisë së kulturës duhet të veprojë, edhe në zonën e vet, të cilët ata e menaxhojnë duhet të kërkohet.

Dafina Alishani: Gabim.

Çelë Lamaj: Jo hiç s'është gabim, në mënyrë urgjente duhet të kërkohet për tana parregullësitë që ndodhin brenda zonës historike që të veproj inspektoriati.

Dafina Alishani: Qendra rajonale është rekomandues e informan inspektoriatin.

Çelë Lamaj: A e kanë inspektoriatin e vetë, e kanë inspektoriatin e vetë ministria e kulturës.

Dafina Alishani: Pyete ish ministrin e din.

Çelë Lamaj: Në kohën e ministrit është bë edhe inspektoriati i cili del edhe janë për mbrojtje. Kur u qit ai betoni aty i atij kalldërmi, aty veproi inspektoriati prej atje erdh tha ma dëmton tha zonënteme. Edhe tash, edhe tash duhet ata me i pa dhe me bë shpejt pse nuk reagan për ato

konstruksione metalike të cilat i haqem ne, pse nuk reagojnë për paklingjet ilegale të cilat janë në zonën historike që janë të ndalume me ligjin mbi zonën historike? Pse nuk reagojnë? Inspektoriati duhet se është zonë e tyre, pse nuk reagojnë?

Dafina Alishani: Inspektoriati komuna.

Çelë Lamaj: Jo jo komuna, inspektoriati i qendrës rajonale për trashëgimi, ata janë menaxhues të zonës historike.

Dafina Alishani: E inspektoriati komunal?

Çelë Lamaj: Edhe ata duhet, inspektoriati komunal e ka ndërtimin të cilin zhvillohet në zonën historike, nëse nuk reagon reagon edhe inspektoriati.

Dafina Alishani: Edhe reklamat i ka.

Çelë Lamaj: Për pa rregullësitë që ndodhin aty, për çka është atëherë ai inspektoriati?

Dafina Alishani: Për çka është inspektoriati komunal?

Çelë Lamaj: Për çka është ai inspektoriati në Prishtinë po të pyes?

Dafina Alishani: Për çka është inspektoriati komunal?

Çelë Lamaj: Edhe unë po të pyes pse është ai inspektoriati atje i caktuar në nivel Kosove, i cili duhet ta menaxhon. Nëse në oborrin tan, dëgjo nëse në oborrin tan vij unë edhe bëj diçka, ti duhesh me reagu, ti duhesh me reagu.

Dafina Alishani: Dëgjo drejtor, me mandate tana si top i ping pongut qekjo mes qendrës rajonale, QRTK-ja edhe inspektoriati, ai e gjuan fajin te ata, këta e gjuajnë te këta.

Çelë Lamaj: Kur është menaxhu prej komunës ka qenë krejt raporti tjetër, krejt raporti tjetër ka qenë prej komunës.

Dafina Alishani: Kush u menaxhu prej komunës.

Çelë Lamaj: QRTK-ja, ka qenë organ i komunës.

Dafina Alishani: Po dhe çfarë ka bërë?

Çelë Lamaj: Po edhe në atë kohë qashtu qysh ka ba, çka ka ba.

Dafina Alishani: Çka ka bë? E dimë çfarë ka bë për qendrën historike, sa mandate të kalumen, e dimë çfarë ka bërë inspektoriati?

Çelë Lamaj: Atëherë mundesh me gjujt përgjegjësinë, se është përgjegjës komplet komuna e Prizrenit. Por momentalisht ti në qendrën rajonale për trashëgimi kulturore.

Dafina Alishani: QRTK-ja, veç rekomandon, a është qashtu.

Çelë Lamaj: Po po, duhet me qu në Prishtinë.

Kujtim Gashi: Po mendoj që temën pak e keni ngartuar se kjo nuk e trajton reklamat në qendrën historike.

Dafina Alishani: Qysh se trajton?

Kujtim Gashi: Jo jo, ato janë përcaktuara me ligj të qendrës historike. Këto reklama është fjala për komunën e Prizrenit ku kanë me u qit lokacionet, tash ti kur e bën një plan ku kanë me u vendosur ti e planifikon edhe në shatërvan, por sun e qet në shtatërvan pa qato rregulla.

Çelë Lamaj: Jo pa pëqimin absolut jo.

Kujtim Gashi: Vetëm Lokacionet janë përcaktu, domethënë këtu mund me qit një reklam. Ama nëse qaj vend i plotëson kriteret që parashiten me ligj, pjesën tjetër 90%. duesh me trajtu me një vendim të kuvendit. Domethënë kemi dy gjëra të.

Dafina Alishani: Ose unë nuk jam në këtë kuvend ose ju s'pom ngoni mirë. Komisioni i QRTK-së erdhi para disa seancave, çka na tha? Nuk po respektohet ligji për trashëgiminë kulturore për qendrën historike, reklamat nën 1m2 duhet me u heq, asnjë s'është heq!

Kujtim Gashi: E saktë.

Dafina Alishani: A është ashtu? Tash ju po doni unë me besu që një vendim ka me qenë mbi ligj edhe qytetari ka me respektu vendimin ama ligjin s'ka me respektu.

Kujtim Gashi: Ama veç ato edhe janë të trashëgume gjatë.

Dafina Alishani: Po e dimë që janë të trashëgume.

Kujtim Gashi: Nuk po flasim për një problem aktual, po flasim për një problem mas luftës ose edhe para luftës.

Çelë Lamaj: Tash a po don me ta sqaru këtë pjesën tjetër? Në projektin e shatërvanit tash për zonën e ngushtë po të flas ku kanë me u trajtu shumë objekte, kanë me u trajtuar me fasada, me reklama, me vitrina, me kulme, me komplet qendra e shatërvanit, komplet ka me u trajtu. Edhe kur ta trajtojmë na fasadën kena me e kqyr a mund të vendoset reklame, marrim pëlqimin prej QRTK-së, kena me bë një projekt kena me e çu aty pa miratimin e tyre ne s'mund të bëjmë kurrgjë si ta miratojmë ato, ne kena me marrë edhe një leje në urbanizëm për me mund me e trajtu një reklamë e cila ka dimensione dy me tri.

Dafina Alishani: Drejtor ti kur e ke mirë, unë them e ke mirë. Por unë kur e kam mirë kurrë se pranon, dësh me pranë që inspektoriati nuk o tu vepru në qendër historike, ai koleg, në një. Nën dy, tuj i ditë kapacitetet e urbanizmit unë dyshoj që qekjo ka me u realizu me reklama, a po don me te kallxu.

Çelë Lamaj: Po s'ka qare se une lypj leje, se kjo kjo menaxhohet prej Drejtorisë së Shërbimeve Publike, jo prej urbanizmit.

Dafina Alishani: Unë po tham, kapni reklamat që janë me ligj rregulloni.

Çelë Lamaj: Ti si ta sheh një reklamë të re mbasi të kalon krejt kjo që o ka qitet pa leje, menjëherë reago, reago. Dafina nuk ka shansë me kaluar asnjë reklamë, një lokacion pa marrë një leje.

Dafina Alishani: Ne kemi humb kohë për rregullore thojshit na ka kthy ministria sun po veprojmë, ttash po shkoni nëpër ortakoll po thoni ministria na ka çu me heq konstruksionet.

Çelë Lamaj: Jo, jo bre çfar.

Dafina Alishani: Beso bre drejtor se qetu çka flas.

Çelë Lamaj: Jo bre leje, çfar ministria, leje ti atë punë.

Dafina Alishani: Qysh ëfarë ministria, i keni thanë njerit na s'po dojna me ju hjek por ministria na ka thënë.

Çelë Lamaj: Po ja u hjekëm, ja u hjekëm.

Dafina Alishani: Po dilni si burra kallxoni që ligjin se keni respektu, tash ju ka ra në mend me respektu.

Çelë Lamaj: Burrnisht ja u kena hjek.

Dafina Alishani: Burrnisht ja u kena hjek,

Çelë Lamaj; Po mirë ma mirë sot se hiç.

Dafina Alishani: Ligji për për qendrën historike është edhe është dashur me u respektu, qoftë prej inspektoriatit, qoftë prej.

Çelë Lamaj: Prej autoritetit i cili menaxhon qendrën historike është autoriteti i parë i cili duhet me e ruajt pronën e vet edhe ata i kanë tona organet të cilët munden me i parandalue.

Dafina Alishani: Këshill rekomandues është.

Çelë Lamaj: Po çfarë rekomandues, thotë nëse nuk e merr pëlqim prej tyre sun merr lejë hiç faza e parë e një intervenimi edhe një kubze në shadërvan nëse duhet me heq duhet me marrë s'ta dha

pelqimin s'mundesh me i heq. Unë gropa kam dashur me mshel, aty mu dasht me marrë pëlqim edhe këta tuj i analizu se grupën a bën me mshel a qysh me mshel a tek me mshel. Dafinë këto janë tan kohën bëhen, ato e kanë qat autoritet, nuk mundemi me intervenu pa lejën e tyre absolut kurgjë brenda sheshit shatërvanit. Një vjet më ka zgjat leja e ndërtimit për sheshin për me ndërru kubzat e shatërvanit.

Dafina Alishani: Mos u anko bre për QRTK-në bile ti.

Çelë Lamaj: S'jam tuj u anku por 1 vit po zgjat.

Dafina Alishani: Mandatin e kalum çdo dy ditë opozitën kryesore e ke pas QRTK-në, qetash zani si nihet se është në qeverisje PDK-ja. Ju mos u ankoni për qeto sene.

Çelë Lamaj: Tash mos i politizoni gjërat.

Dafina Alishani: Jo s'është politizim kjo por është realitet.

Bajram Kastrati: Te pika, te rrethrotullimet drejtor, a ka ndonjë rregull të veçantë? Se tash te rreth rrotullimit mirë që s'koka edhe rreth rrotullimi të ish banafi, se aty mujn me hy edhe në Skënderbeg. Po mua po më duket paska disa re rrotullime që është mirë me i pa çfarë rregulla ka, se po më duket në rreth rrotullim me pas reklama të ndryshme aty mundeni edhe a keni parapar ato.

Çelë Lamaj: Po po, gjithsesi unë po them në mënyrë profesionale janë trajtuar të gjitha lokacionet ku mund të vendosen reklamat, edhe në rreth rrotullime nuk kanë me qenë reklamat që kanë me pengu zhvillimin e komunikacionit. Janë dhënë nuk e di tash, se ju tash po doni me um shti në fushën e urbanizmit.

Bajram Kastrati: Jo jo, a është paraparë që nuk e pengojnë?

Çelë Lamaj: Jo absolut, po ne s'jemi për me i pengu.

Bajram Kastrati: Normalisht s'jam ekspert i asaj por unë po menoj që.

Dafina Alishani: Qe po të kallëxoj, komuna s'ka pas kapacitet mirëmbajtjes, ja ka dhënë biznesit i ka thënë bëne ti një faqe aty, qiti reklamat e tua ama mirëmbajtja të takon ty. Ama marrëveshje me letër s'ke!

Bajram Kastrati: Dafina, ideja ke sipas ekspertëve a e pengojnë komunikacionin, sepse se pata fjalë për Skenderbegun.

Çelë Lamaj: Jo jo, nuk ka pjesë të ledave që na bëjnë kështu që kanë me pengu komunikacionin, hyni pak në internet edhe kqyrni.

Bajram Kastrati: Fjala ke për bustin e Skenderbeut, po më duket e keqkuptove.

Antigona Bytyqi: Nëse s'ka dikush diçka tjetër, po e hedhim në votim që ti rekomandohet mbledhjes së ardhshme. Prezent jemi shtatë anëtarë, kush është për? katër jemi për, tre kundër. Atëherë edhe kjo pikë i rekomandohet mbledhjes së ardhshme dhe do të jetë në renditje para pika të tjera, domethënë para pikave të cilat janë raportet.

Kujtim Gashi: A doni me shty për një orë nesër seancën, i kemi homazhet.

Antigona Bytyqi: Po se harrova, nesër po edhe në jemi munduar me gjetë një farë që me mbajt homazhezhet para seancës por në bashkëpunim me OVL-në është vendosur ora 10:00. Faleminderit nënkryetar për rikujtim.

Dafina Alishani: Qysh edhe nesër s'ka.

Antigona Bytyqi: Nesër seancë solemne është, për seancën e rregullt është tuj folë, për pasnesër.

Kujtim Gashi: Për të rregulltën po flas.

Dafina Alishani: Po a s'kemi nesër edhe Homazhe?

Antigona Bytyqi: Jo vetëm seancë, kështu është kalendari edhe prej OVL-së.

Kujtim Gashi: Kështu janë organizu edhe në nivel të Kosovës, domethënë një axhendë e njëjtë.

Antigona Bytyqi: Se kështu e kam mendu edhe unë edhe homazhe edhe seancë nesër.

Bajram Kastrati: Do të thotë nesër veç seancë kemi.

Kujtim Gashi: Na krejt axhendën që e kemi pasur për nesër është anuluar.

Antigona Bytyqi: është fjala për seancën e e rregullt.

Karanfil Haxhillari: Nesër është në ora 11:00 seanca?

Antigona Bytyqi: Po edhe pasnesër, në ora 10:00 janë homazhet.

Dafina Alishani: Kryesuese të njoftohen edhe shefat e grupeve, te kryhet pjesa teknike.

Antigona Bytyqi: Atëherë po i njoftoj edhe te grupi i shefave, por nuk kemi mund me bë më herët. Faleminderit për kontributin dhe pjesëmarrjen, shihemi në mbledhjet e ardhshme.

Përfundoi në ora 11:52 minuta

Kryesuesja e Kuvendit
Antigona Bytyqi

